“Being different in gender” and “being different ethnically in tribes and nations should lead us to get to know each other, make us interesting to each other, learn from each other and be challenged to compete in doing good, not to dispise and fight each other as was indicated earlier in a verse⁴⁹. The diversity of colors and languages is one of the signs of God which has been confirmed in the Qur’ān with a verse saying that: “And among His signs is the creation of the heavens and the earth, and the diversity of your languages and colors. Surely in this are signs indeed for people who have knowledge (of the facts in creation and who are free of prejudices)⁵⁰.” Diversity has no ground for either superiority or inferiority so as to be understood from the aforementioned verses. To be a better human being the only criterion acknowledged by the Qur’ān is righteousness not even religious claim such as theological correctness as indicated in a verse: “...the most honorable of you in God’s sight is the one best in piety, righteousness, and reverence for God. Surely God is All-Knowing, All-Aware⁵¹.”

48. Tirmidhī, al-Birru vaṣ-Ṣilatu, Bāb:4.

49. Hujurāt, 49:13.

50. Rūm 30:22.

51. Hujurāt, 49:13.

BIBLIOGRAPHY

Bukhārī, Muḥammad b. Ismā‘īl. (ed. Muṣṭafā Dīb al-Bugha). *Ṣaḥīḥ al-Bukhārī*. Beirut: Dār Ibn Kathīr, 1987/1407.

Glazer, Nathan. “Diversity.” in *New Dictionary of the History of Ideas*. ed. Maryanne Cline Horowitz et al. New York: Thomson Gale, 2005. pp.590-593.

Gülen, Fethullah. “Three Great Dangers”. *The Broken Jug*, March 15, 2015. Accessed April 09, 2015. <http://www.herkul.org/weekly-sermons/three-great-dangers/>.

Gülen, Fethullah. “True-Hearted, but Not a Chauvinist”. *The Broken Jug*, April 04, 2013. Accessed April 01, 2015. <http://www.herkul.org/weekly-sermons/true-hearted-but-not-achauvinist/>.

Ḥamidullah, Muḥammad (d. 1424). *Majmūatu’l-wathāiqi’s-siyāsiyya li’l-‘ahdi’n-nabawī wa’l-Khilāfati’r-Rāshida*. at-Tab‘atu’s-sādisa. Bairūt: Dār an-Nafāis, 1407.

Hākīm, Abū ‘Abdullāh Muḥammad bin ‘Abdullāh (321405/933-1014). *al-Mustadrak ‘alaṣ-ṣaḥīḥayn*. (ed. Muṣṭafā ‘Abd al-Qādir ‘Aṭā). Beirut: Dār al-Kutub al-‘Ilmiyya, 1990/1411.

Ibn al-Athīr, ‘Izzuddīn Ebū al-Ḥasan ‘Ali b. Muḥammad b. ‘Abdulkarīm (d. 630/1232). *Usd al-ghāba fī ma’rifat aṣ-ṣahāba*, I-VII. Beirut: Dār al-Fikr, 1409/1989.

Ibn Kathīr, Abū al-Fidā Ismā‘īl b. ‘Umar b. Kathīr al-Qurashī ad-Dimashqī Ibn Kathīr (701/1301-774/1373). *Tafsīr al-Qur’ān al-‘Azīm*. (ed. Sāmi b. Muḥammad b. Salāma). aṭ-Ṭab’a ath-Thāniya. Riyāḍ: Dār at-Ṭayyiba, 1999/1420.

Kurucan, Ahmet and Mustafa Kasım Errol. *Dialogue in Islam (Qur’an - Sunnah – History)* London: Dialogue Society, 2012.

Māturīdī, Abū Manṣūr (853-944 AD). *Ta’wīlāt ahl as-sunnah*. (ed. Majdī Bāsallūm). Beirut: Dār al-Kutub al-‘Ilmiyya, 2005/1426.

Qurtubī, Abū ‘Abdillāh Muḥammad b. Aḥmad b. Abī Bakr b. Farḥ (d. 671/1273). *al-Jāmi’ li aḥkām al-Qur’ān*. (ed. Hishām Samīr al-Bukhārī). Riyāḍ: Dar ‘Ālam al-Kutub, 2003/1423.

Stillman, Norman A. *The Jews of Arab Lands: A History and Source Book*. Philadelphia: The Jewish Publication Society of America, 1979.

al-Shātībī, Abū Ishāq Ibrāhīm. *al-Muwāfaqāt fī uṣūl ash-sharī’a*. (ed. ‘Abdullāh Drāz). Bairūt : Dār al-Ma’rifa, 1980.

Ṭabarī, Abū Ja’far b. Jarīr Muḥammad b. Yazīd (224/838310/923). *Tafsīr at-Ṭabarī: Jāmi’ al-bayān ‘an ta’wīl al-Qur’ān*. (ed. Aḥmad Muḥammad Shakir). Madīna: Muassasat ar-Risāla, 2000/1420.

Thomass, Barbara and Indira Dupuis, “Media Implications of Diversity: As a Reality, as a

Normative Concept and as a Pragmatic Concept for Human Resources Management,” in *Diversity in Transcultural and International Communication*, ed. Carola Richter, Indira Dupuis and Stefanie Averbek-Lietz (Wien: LIT Verlag, 2016), pp.15-34.

Tirmidhī, Abū ‘Īsā Muḥammad b. ‘Īsā b. Daḥḥāk. *Sunan at-Tirmidhī*. (ed. Aḥmad Shakir). Beirut: Dār Iḥyā at-Turāth al-‘Arabī, n.d.

Tlili, Sarra. *Animals in the Qur’an*. New York: Cambridge University Press, 2012. pp. 99-103.

Al-Turki, Abdullah bin Abul Mohsin and others. *Interfaith Dialogue Cross-Cultural Views*. Riyadh: Ghainaa Publications, 2010.

al-Wāqidi, ‘Abū ‘Abd Allāh Muḥammad ibn ‘Umar (130/748 -207/822). *Kitāb al-maghāzī*. (ed. Marsden Jones). at-Ṭab‘a ath-thālisa. Beirut: Dār al-A‘lamī, 1409/1989.

Yücel, Salih and İsmail Albayrak, *The Art of Coexistence: The Pioneering Role of Fethullah Gülen and the Hizmet Movement*. New Jersey: Tugra Books, 2014

Shqip

Genti KRUJA¹

Kolegji Univeritar Bedër

Departamenti i Shkencave Islame

Bashkëjetesa ndërfitare në Shqipëri si faktor stabiliteti social

Abstrakt

Nevoja për dialog midis popujve dhe ithtarëve të besimeve dhe pikëpamjeve të ndryshme fetare, etnike, kulturore dhe politike është përforcuar shumë sidomos vitet e fundit. Dialogu, sidomos ai ndërfitar, është parë si një prej alternativave për të shumëpërfolurën “përplasje e qytetërimeve”. Ata që nuk janë pajtuar me një teori të tillë, këmbëngulin në dialogun e qytetërimeve, kulturave dhe besimeve të ndryshme fetare.

Për sa u përket studimeve sociologjike shqiptare të periudhës postkomuniste është argumentuar se krahas vlerave kulturore të besës dhe mikpritjes, mirëkuptimi dhe bashkëjetesa ndërfitare të shqiptarët, përbëjnë disa nga profilet më të spikatura të modelimit psikokulturor të shqiptarëve në të gjithë historinë e tyre. Ndërkohë, në mjaft shoqëri më të urbanizuara, në rrjedhën e disa shekujve, madje edhe në ditët tona, konfliktet kanë qenë dhe vazhdojnë të mbeten një sfidë e rëndë problematike në shumë rrafsh, sociale e politike, fetare e psikokulturore. Në këtë sfond ndër-kombëtar, ku vihen re dukshëm konfliktet me karakter të ndryshëm, mirëkuptimi ndërfitar i shqiptarëve, përbën ndoshta një model, jo vetëm për Ballkanin dhe rajonin e trazuar, por një model edhe për Evropën, e pse jo edhe për botën. Vlera kulturore e mirëkuptimit ndërfitar të shqiptarëve është pak e studiuar dhe më pak pak e argumentuar, ndaj çdo përpjekje për depërtimin në thelbin e një vlere të tillë komplekse, shumëfunktionale, për ta evidentuar atë përmes strukturave konceptuale sociologjike, ka rëndësi të veçantë teorike e praktike, jo vetëm për shoqërinë shqiptare, por edhe më gjerë.

Shqiptarët janë gjithashtu një popull me densitet të lartë të multifetaritetit. Ndonëse të shpërndarë në disa komunitete fetare, shqiptarët nuk janë konfliktuar njëri me tjetrin për çështje fetare. Madje, në shumë aspekte, dallimet fetare kanë “funktionuar” si një faktor, që ka fashitur ose tejkaluar edhe konfliktet e provokuara për motive të tjera. Kështu, sikurse nuk ndodh në asnjë vend tjetër të botës, dallimet fetare në Shqipëri veprojnë si faktor kundërkonfliktues.²

1. Përgjegjës i Departamentit të Shkencave Islame, KU Bedër.

2. Dervishi, Zyhdi (parathënie); Kruja, Genti, “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfitar”, Tiranë, Prizmi, 2008:9-11.

Në këtë punim shkencor do të mundohemi të paraqesim disa fakte të rëndësishme historike përmes një qasjeje sociologjike lidhur me sfidat e mirëkuptimit ndërfetar te shqiptarët dhe bashkëjetesën ndërfetare në Shqipëri, si faktor të stabilitetit social.

Fjalë kyçe: Dialogu, mirëkuptimi, harmonia, bashkëjetesa ndërfetare, stabilitet social.

Bashkëjetesa ndërfetare te shqiptarët

I.1. Si lindi harmonia fetare në Shqipëri?

Gjykuar në pikëpamjen horizontale-sinkronike, shqiptarët janë një popull ku bashkëjetojnë të dyja fetë abrahamike, Krishtërimi dhe Islami. Secila nga të dyja besimet abrahamike ekzistojnë së bashku me degëzimet përkatëse. Kështu popullsia shqiptare ka dy bashkësi të krishtera: krishtërimin katolik dhe atë ortodoks. Po ashtu, kjo popullsi ka edhe dy komunitete të një bashkësie Islame: atë mysliman suni dhe mysliman bektashi. Si në çdo vend tjetër në botë, edhe në Shqipëri ka ateistë (sipas censurit të fundit, 2.5 %), po ashtu besimtarë, që nuk ushtrojnë rite dhe nuk janë praktikantë të ndonjë faltoreje, si dhe familje të përziera me shumë besime brenda tyre. Në gjysmën e parë të shekullit XX ka ekzistuar dhe një bashkësi hebraike dhe fillesat e një bashkësie protestane (ungjillore). Vetë shteti shqiptar është shtet laik dhe sipas kushtetutës së vendit shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare, por kjo gjë nuk përjashton përgjegjësinë e shtetit për krijimin e kushteve për ringjalljen dhe zhvillimin e fesë dhe të institucioneve fetare, sidomos në tranzicionin postkomunist.

Në viset e brendshme të Shqipërisë malore ritmet e shtrirjes së krishtërimin, duket se qenë të ngadalshme, përderisa mbajtësit e objekteve, që u gjenden në varrezat e hershme mesjetare (Kultura e Komanit - shek. VI-VIII), në përgjithësi praktikonin rite varrimi pagan. Krishtërimi në ato vise fuqizohet pas krijimit të temës së Durrësit (shek. IX-X).³ Me ndarjen e kishës më 1054, nga treva arbërore vetëm peshkopatat e Tivarit, e Durrësit dhe e Shkupit mbetën në varësi të Romës. Durrësi gjatë shekujve XIII-XVI luhet në mes të Kishës Perëndimore e asaj Lindore, sipas rrethanave politike. Kjo paqëndrueshmëri vërehet edhe tek disa sundimtarë të Arbërit. Dhimitri së bashku me klerin, fisnikët e popullin më 1209 kthehen nga ortodoksë në katolikë. Me 1216 Grigor Kamona rikthehet në ortodoks. Në një përshkrim të vitit 1308 përmenden banorët e Kunavisë, Stefaniakës, Pultit e Dibrës, të cilët nuk ishin “thjeshtë katolikë, as thjeshtë skizmatikë”.⁴

3. Anamali, Skender, ‘Ilirët dhe shqiptarët’ në “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, 1990:42-43.

4. Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1962:111; Xhufi, Pëllumb, “Shqipëria dhe bota mesdhetare në Mesjetë” (shek. XI-XIV), “Studime historike”, 2, 1990:183, si

Megjithatë feja dhe kultura te shqiptarët ishin elemente të pandara të jetës së përditshme, që së bashku me gjuhën përbënin identitetin kombëtar.

Populli shqiptar me dy besime: islam dhe të krishterë, ka qenë, është dhe duhet të jetë shembull i veçantë dhe simbol i harmonisë fetare në historinë e popujve të Ballkanit dhe më gjerë. Myslimanë dhe të krishterë kanë jetuar në harmoni dhe kanë bashkëjetuar pa konfrontime përçarëse në mes vete, përkundrazi ata kanë plotësuar njëri-tjetrin. Vetë ekzistenca e objekteve të kultit, xhamive, kishave e teqeve, simbolizon historinë e vendit tonë. Edhe e ardhmja e Shqipërisë dhe e shqiptarëve do të jetë e lumtur, në qoftë se pjesëtarët e Islamit dhe të Krishterimit do të përqafojnë secili fenë e vet me dije dhe vepër dhe të respektojnë njëri-tjetrin.

Si vëllezër nga gjaku, por edhe si myslimanë e të krishterë, shqiptarët duhet të kuptojnë njëherë e përgjithmonë, se realiteti dhe fati, jo vetëm i tyre, por i gjithë botës, që nga fillimi deri në mbarim të saj, është larmi besimesh e bindjesh. Shqiptarët nuk do të kenë përçarje fetare përderisa të besojnë se fetë në Shqipëri janë pasuri, e jo fatkeqësi dhe se Krijuesi i vetëm është për të gjithë i njëjtë, për myslimanë e të krishterë.

Në shkrimet e mendimtarëve dhe udhëpërshkruesve joshqiptarë gjenden mjaft karakterizime për këtë çështje. Për shembull, Hugo Adolf Bernatziku për shoqërinë shqiptare të vitit 1929, kur ai vizitoi mjaft qytete e krahina të Shqipërisë, ka shkruar:

“Katolikë, të krishterë ortodoksë dhe myslimanë jetojnë në paqe në këtë vend të vogël, madje, shpesh edhe në fshatra jetojnë së bashku. Luftërat fetare janë të panjohura dhe të pakonceptueshme për shqiptarin”.⁵

Ndërsa Edith Durham ka shkruar se “një pjesë e shqiptarëve... kanë kaluar direkt nga paganizmi në Islam.”⁶

Studiuesi Zyhdi Dervishi konstaton se ndjenja fetare e shqiptarëve nuk është e sipërfaqshme, por është e pamjaftueshme njohja e studiuesve dhe udhëpërshkruesve të huaj për një ndjenjë të tillë. Këtë përfundim e vërtetojnë fakte të shumta, të pakundërshtueshme të realitetit fetar në Shqipëri.

Kështu gjatë 3-4 shekujve të fundit, ndonëse mjaft i varfër, populli shqiptar ka pasur dëndësi të lartë të kishave, xhamive dhe teqeve.

Kështu, duke mos pasur instinktet e turmave, shqiptarët pothuajse asnjëherë nuk i kanë keqtrajtuar grupet shoqërore në pakicë, të formuara mbi baza racore,

dhe Ulqini, Karaman, “Faktorë kulturorë e fetarë”, Shkodër 1999:8.

5. Bernatzik, Hugo Adolf, “Shqipëria-vendi i shqiptarëve”, botuar nga Uegen, Tiranë, 2003:154.

6. Durham, Edith, “Bregja e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë edhe shqiptarët”, Sh.N. “8 Nëntori”, Tiranë, 1990:158.

etnike, nacionale, fetare etj. Historikisht dhe aktualisht grupet shoqërore në pakicë kanë qenë dhe janë të mbrojtur nga toleranca, prirja për mirëkuptim dhe fryma humane e grupeve shoqërore në shumicë.

Madje, sa më të shpërpjesëtuar të jenë raportet numeriko-demografike ndërmjet grupit të njerëzve me përkatësi fetare të njëjtë në pakicë dhe grupit me përkatësi tjetër fetare në shumicë, aq më e mirëkuptuar është pakica nga shumica.

Sipas sociologut Dervishi, me përjashtime fare të rralla, në shoqërinë shqiptare në shumë aspekte je më i favorizuar nëse je anëtar i grupeve shoqërore në pakicë, sesa anëtar i grupeve shoqërore në shumicë.⁷

Çështja e mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve shfaqet si rebus, gati i padeshifrueshëm në sfondin e dyfishtë të realitetit socialkulturore mbizotërues të shumë shoqërive të ditëve tona, të cilat përjetojnë konfliktime fetare problematike dhe të një mjegulle të dendur paragjykimesh, që vjen nga jashtë dhe deformon pamjen e vlerave të shoqërisë shqiptare.

Dallimet fetare tek shqiptarët nuk “funksionojnë” si burim konfliktesh. Përkundrazi, dallimet fetare ndikojnë, që shqiptarët të jenë më të matur në marrëdhëniet me njëri-tjetrin dhe të jenë më të prirur të harmonizojnë interesat ndërmjet tyre.⁸

Shqiptarët lakojnë shumë togfjalëshin “harmoni fetare” dhe e kanë burim krenarie faktin se në shoqërinë shqiptare mbisundon kjo harmoni. Kohët e fundit gjetja e formulës “magjike” të harmonisë fetare nuk është temë vetëm e Shqipërisë, por e mbarë botës. Tradita e bashkëjetesës ndërfetare tek shqiptarët nuk është diçka e formuar në kohët moderne, por është një traditë, që vjen nga thellësia e shekujve, por sigurisht këto vlera nuk janë të përjetshme, por duhen ruajtur e trashëguar në mentalitetin e njerëzve.

Sipas studiuesit Artan Fuga, ndryshimet në pikëpamjet fetare dhe në besimet mistike nuk e përjashtojnë bashkëpunimin midis bashkësive të ndryshme fetare. Kjo vjen për arsye se fetë e mëdha monoteiste, sado të dallueshme dhe kontradiktore të paraqiten me njëra tjetrën, kanë përsëri gjëra të përbashkëta, të cilat mund të shtrojnë rrugët e bashkëpunimit për përsosjen morale të njerëzve, për të rritur shkallën e solidaritetit midis tyre, për të forcuar ndjenjat e humanizmit, të faljes, mëshirës, si dhe për të krijuar një sfond moral kundërshtues kundër vjedhjes, torturës, violencës, vrasjeve etj.

7. Dervishi, Zyhdi, “Fakte rrjedhëse të mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve: një provë shpjegimore”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:156.

8. Po aty.

Të gjitha fetë e mëdha monoteiste bazohen në pranimin e idesë të së mbinatyrshmes. Adhurimi i Zotit dhe dashuria për të tjerët përbëjnë themelet e mësimave fetare. Mësimet morale për paqe, respektim të jetës, mirëkuptim etj., gjenden te të gjitha fetë monoteiste, që kultivohen në vendin tonë.⁹

Nga kjo pikëpamje, kjo metaforë na mëson se perspektivat e ndryshme fetare, morale ose shkencore mbi botën nuk ka përse të jenë aspak në vetvete burim konfliktesh dhe fanatizmash, por një motivim humanist për një hapje drejt tjetrit, për një njohje të tjetrit në kulturën e tij të veçantë, që sikurse thotë edhe Habermasi, përbën pikërisht konceptin e saktë mbi universalen. Universalja, pra, si tërësi dallimesh në komplementaritetin e tyre.¹⁰

Shqipëri: ruajtja e mirëkuptimit mes komuniteteve fetare

Krerët e shtetit shqiptar herë pas here në tubime pune dhe konferencat ndërkombëtare i kanë bërë të ditur botës tolerancën dhe harmoninë fetare që ekziston në Shqipëri.

Presidenti Moisiu në Forumin e Oxfordit “Toleranca ndërfaqetare në traditën e popullit shqiptar”,¹¹ në vitin 2005, ka shprehur besimin se emigrantët shqiptarë të viteve 1990-të në përgjithësi përcollën në Perëndim një imazh të një Shqipërie të dhunshme, të vrazhdë, rrezikuese. Shumë shpejt, në mjediset politike dhe shkencore të Perëndimit doli pyetja: A ekziston një Shqipëri tjetër, një Shqipëri me fytyrë evropiane, një Shqipëri nga e cila mund të gjendeshin vlera të mbijetuara të qytetërimit?

Ishte pikërisht kjo pyetje, kjo gjendje, kjo nevojë për të ndryshuar imazhin e lënduar të vendit, për të përgënjeshtuar dhe disa prirje tendencioze të shtypit perëndimor, që nxitën studiuesit shqiptarë dhe kolegët e tyre në Evropë për të kërkuar vlera të ndritshme të identitetit shqiptar, si identitet i të njëjtit klas me atë të vendeve të Perëndimit, pavarësisht se e keqja e kishte sjellë të njëjtin për keq. Midis këtyre vlerave, toleranca, harmonia dhe bashkëjetesa ndërfaqetare ishin cilësi, që tërhoqën menjëherë vëmendjen e të gjithë atyre dijetarëve dhe politikanëve, shqiptarë e të huaj, që besonin dhe kërkonin tek populli shqiptar një imazh tjetër.

Ky model përbën një pasuri të çmuar për shqiptarët, por edhe një realitet pozitiv, me vlerë në rajonin ku jetojmë dhe më gjerë. Shoqëritë tona po shkojnë në mënyrë të pashmangshme drejt globalizimit dhe integritit, duke tentuar krijimin e një familje të madhe në të cilën ka vend për të gjitha vlerat dhe pasuritë e kombeve

9. Fuga, Artan, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:26.

10. Po aty, fq. 28.

11. www.president.al, faqja zyrtare e Presidencës, 9.11.2005.

dhe popujve. Në botën globale vendet e vogla nuk pritet të konkurojnë me ekonomitë dhe pasuritë e tyre materiale. Megjithatë, me identitetin dhe vlerat më të çmuara të tyre, ato mund të kontribuojnë në pasurimin e shoqërisë globale, duke krijuar një mozaik të pasur vlerash, kulturash që njohin, respektojnë e zhvillojnë njëra-tjetrën.

«Rasti Shqipëri», si një rast shembullor i bashkëjetesës së besimeve në rrugën e gjatë të historisë, shumë shpejt filloi të trajtohej si “Fenomeni Shqipëri”, i cili mori rëndësi jo vetëm si një çështje kulturore-historike, por, mbi të gjitha, si një përvojë e dobishme për njerëzimin, si një mundësi evokimi dhe inkurajimi në mjedise ndërkombëtare.

Shqipëria ka qenë zona ku takoheshin dhe ndaheshin dy perandoritë më të mëdha të mesjetës: Roma dhe Bizanti. Po ashtu, Shqipëria ishte vendi ku takohej dhe ndahej autoriteti i dy kishave: romane dhe bizantine. Dy perandoritë dhe dy kishat, megjithëse rivale dhe kundërshtarë të forta të njëra-tjetrës, tek shqiptarët asnjëherë nuk u bënë shkak konflikti. “Vija e Teodosit” e ndau qysh në fundin e paleokrishtërimin hapësirën shqiptare në dy pjesë, njëra nën pushtetin politik e fetar roman dhe tjetra nën pushtetin politik dhe fetar bizantin. Por kjo ndarje asnjëherë nuk u kthye në kufi midis vetë shqiptarëve. Islami në Shqipëri është një besim fetar, që bashkëjeton me Evropën prej shekujsh dhe është një prej feve përbërëse të saj.

Toleranca tek shqiptarët nuk është vetëm fetare, por edhe gjuhësore e kulturore dhe në shumë raste edhe etnike. Në vitet e Luftës së Parë Botërore në Shqipëri kishte ushtri të huaja të shumta në numër, gati sa në gjithë Ballkanin: austriake, franceze, italiane, greke, serbe, malazeze e bullgare. Kur lufta mori fund dhe këto ushtri nuk kishin as ushqim, as ilaçe e mjete për t’u kthyer në atdheun e vet, populli shqiptar i mbajti nëpër familje, megjithëse e dinte mirë se shumica e tyre kishin bërë krime mbi vetë shqiptarët. Në periudhën pas 8 shtatorit 1943, kur Italia fashiste kapitulloi, në Shqipëri gjendeshin mijëra milicë dhe oficerë, që kishin ardhur në Shqipëri si ushtri pushtuese. Kjo ushtri u gjend brenda dy javësh e çarmatosur dhe e trajtuar si ushtri dezertore, e destinuar për t’u shfarosur nga ushtria naziste, por populli shqiptar e shpëtoi këtë ushtri nga tmerri që e priste, megjithëse ajo ushtri kishte vrarë e djegur, kishte dhunuar e plaçkitur. Ushtarët italianë u veshën me kostume tradicionale shqiptare dhe u strehuan në familjet e shqiptarëve.

I pashembullt është qëndrimi i shqiptarëve ndaj hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore. Qeveritë shqiptare, që bashkëpunuan me autoritetet fashiste dhe naziste, si kudo në botën e asaj kohe, bashkëpunuan si qeveri vasale, por ato asnjëherë nuk ua dorëzuan ushtrive të huaja listat e hebrenjve. Shqipëria është vendi i vetëm në botë ku, megjithëse në kushte pushtimi të dyfishtë, asnjë hebre nuk u dorëzua, asnjë hebre nuk përfundoi në kampe përqendrimi, asnjë hebre nuk u viktimizua. Dhe nuk është fjala për hebrenjtë e vetë Shqipërisë, shtetas të saj, por për afro 3.000 hebrenj

të ardhur nga shtetet ballkanike, në arrati e sipër për t'i shpëtuar rrezikut të zhdukjes atje ku ishin.¹²

Toleranca përbën edhe një tipar etnotipik të shqiptarëve. Ndoshta kjo cilësi është e lidhur edhe me pozitën gjeopolitike të shtetit shqiptar. Ndërsa Perëndimi e ka parë Ballkanin dhe portën e tij - Shqipërinë - si një Lindje ekzotike; përkundrazi, Lindja e ka parë atë si Perëndim. Në kryqëzim të dy botëve, shqiptarët kanë marrë e dhënë me të dyja, duke ruajtur thelbin e vet identifikues, duke shërbyer si urë kalimi ndikimesh dhe duke përvetësuar edhe vetë prej tyre. Kështu u formua tek shqiptarët bindja historike se dallimi, qoftë ky fetar, rajonal, racor, gjenetik, kombëtar, kulturor etj. nuk është rrezik, por pasuri. Një bindje e tillë ka formësuar tolerancën ndërfaqetare dhe më gjerë tek shqiptarët, një bindje e tillë e ka bërë qytetërimin e saj një qytetërim të hapur.

Pluralizmi paqësor fetar ka shërbyer si element bashkues midis njerëzve, familjeve dhe grupeve të ndryshme në shoqëri. Komunitetet fetare mbeten besnike e frymëzimeve të tyre fillestare të së mirës dhe paqes, si dhe me përkushtim të madh luajnë rol aktiv në kapërcimin e problemeve sociale, shoqërizimin e të rinjve, forcimin e rolit të familjes, kulturës dhe identitetit kombëtar. Me kontributin e tyre të veçantë Shqipëria përfaqëson edhe një nga rastet e rralla të një vendi me besime të ndryshme fetare, ku të gjithë faktorët politikë e shoqëror, përfshirë edhe komunitetet fetare, janë përkrahës të fuqishëm të integritit të vendit në Bashkimin Evropian. Vlerat nuk janë të përjetshme, ato duhen ruajtur e kultivuar në mentalitetin e qytetarëve dhe në kulturën demokratike. Në të njëjtën mënyrë është e nevojshme të shndërrohet kultura e dialogut midis besimeve dhe komuniteteve të ndryshme fetare, në urë bashkimi e komunikimi, shkëmbimi dhe lidhje më të fortë midis njerëzve e vendeve.

Dhe në fakt një vlerë e rëndësishme me të cilën Shqipëria sot krenohet është pikërisht bashkëjetesa mes komuniteteve të ndryshme fetare. Janë të shumtë ata që e konsiderojnë këtë si një pasuri pasi mund të jetë një rast unik, që në të gjithë historinë e vendit, nuk janë shënuar asnjëherë përplasje fetare. Megjithatë shembujt e kohëve të fundit në botë, por edhe në rajonin e Ballkanit kanë dëshmuar se ekuilibrat fetare janë shumë të brishtë dhe shpesh herë manipulimet me to kanë sjellë pasoja të rënda.

Myslimanët, ortodoksët, katolikët dhe bektashinjtë u kanë kërkuar autoriteteve shtetërore që të mbrojnë lirinë e të gjithë përfaqësuesve të autorizuar, apo udhëheqësve fetarë që të përmbushin misionin e tyre. Ata kanë kërkuar hartimin e rezolutës mbi statusin ligjor të komuniteteve fetare, si dhe kthimin e pronave të shtetëzuara, apo konfiskuara në kohën e komunizmit.

12. Presidenti Moisiu, A., Londër, 9.11.2005, fjalim; Loloci, C., gazeta "Trepça", 4 gusht 2005.

Kështu në një studim të tijin Fuga thekson gjithashtu se mungesa e një debati për çështje themelore teologjike nuk është një bazë e sigurt, që na garanton për të pasur gjithmonë paqe sociale dhe bashkekzistencë fetare, që i kemi trashëguar si pjesë përbërëse të thesarit kombëtar deri më sot. Konflikti social dhe dasitë me bazë sociale dhe fetare mund të lindin nëse nuk trajtohen demokratikisht, edhe nga dallime të dorës së dytë, jo të mirëfillta fetare, por “mbi fenë”, për shembull lidhur me vendosjen e një monumenti në një rrugë qyteti, me formën e kangjellave, që rrethon një ndërtesë publike, me vendosjen e një simboli fetar në një kodër a në një buzë rruge, mbi një çështje varresh, dhe për çështje të tjera, që nuk kanë natyrë të mirëfilltë teologjike. Në këtë rast konflikti, në të vërtetë, nuk e ka bazën e vet brenda fushës së mirëfilltë të dialogut ose të debatit, por e gjen burimin në lindjen dhe maisjen e disa konflikteve sociale, që e gjejnë pastaj shprehjen e tyre te divergjenca simbolike, gjuhësore ose alternativash për shpjegimin e historisë. Baza e këtij debati jo fort demokratik, që e kemi njohur kohët e fundit në disa raste, ka të bëjë më tepër me divergjenca sociale, rajonale, grupimesh shoqërore, gjeopolitike, të cilat i përdorin dallimet fetare ose historitë e marrëdhënies midis kombit dhe feve, si instrumente ideologjike veprimi në të sotmen dhe si objektiva për t’u arritur në të ardhmen.¹³

Qëllimi më i lartë i dialogut ndërfaqet, moral, politik është që ai ta mbajë gjithmonë të gjallë veten e vet, pa shkarë në fanatizëm dhe skajshmëri të të gjitha llojeve. Nëse deri tani në Shqipëri ai e ka ruajtur veten e tij, duke qëndruar pak në hije, në të ardhmen, ai me siguri që do të ndodhet përballë sfidash të reja, ku do t’i duhet ta pohojë veten e vet jo nëpërmjet mungesës, por nëpërmjet një filozofie, metode dhe kulture, që frymëzon tolerancë dhe bashkëjetesë.¹⁴

Nga të dhënat sociologjike që janë mbledhur, gjykohet se në shoqërinë shqiptare përkatesitë fetare të besimtarëve të ndryshëm nuk i kanë mbyllur ata brenda një ndërgjegjeje dhe lidhjeje të ngushtë ekskluzive të përcaktuar nga feja e tyre.

Dialogu ndërfaqet nuk është një dukuri vetëm brendafetare. Ai përfshin edhe një debat të kuptueshëm dhe fare të natyrshëm edhe midis besimtarëve dhe jobesimtarëve, laikëve, ateistëve, për probleme, që kanë të bëjnë me kuptimin e botës, të shoqërisë dhe të vetë njeriut. Lidhur me këto probleme as shkenca e as filozofia, nuk mund të pretendojë se kanë ekskluzivitetin e trajtimeve të sakta, pikërisht sepse ato nuk mund të jenë veçse gjykime interpretuese. Të gjitha këto forma të mendimit dhe të ndërtimit të vlerave shpirtërore kanë si qëllim human realizimin e kushteve të paqes, të mirëkuptimit dhe të konsolidimit të pozicionit të njeriut në botë dhe të për-

13. Fuga, Artan, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfaqet në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:32.

14. Po aty, 35.

gatitjes së tij për të përballuar sfidat, që kanë të bëjnë me jetën ose edhe me vdekjen e tij. Dhe këtë rol i takon ta luajnë liderët fetarë.

Nuk duhet harruar se nga pikëpamja filozofike-fetare, feja dhe shkenca, nuk konceptohen më si të ndara dhe armiqësore me njëra-tjetrën, por si dy regjistra të ndryshëm, komplementarë, të të kuptuarit të botës, si dy mënyra plotësuese të leximit të botës dhe të njeriut.

Sikurse del edhe nga studimet e ndryshme, fetë, pavarësisht dallimeve, kanë edhe tipare të përbashkëta. Besimi te i Gjithëfuqishmi, te pavdekësia e shpirtit, aq më shumë insistimi te ruajtja dhe konsolidimi i vlerave morale, sikurse janë ndershmëria, respekti ndaj tjetrit, dashuria dhe miqësia, toleranca, falja, etj., karakteristika të shumicës së besimeve fetare, përbëjnë atë bazë ku fetë e ndryshme, por edhe filozofët, gazetarët, sociologët, shkencëtarët, besimtarët, laikët, skeptikët apo edhe ateistët, kanë një hapësirë të gjerë jo vetëm dialogu të shëndoshë, por edhe bashkëpunimi dhe mirëkuptimi të thellë.

Kuptohet qartë, sikurse e kanë vënë mirë në dukje teologë të shquar të kohëve tona ose të së kaluarës, ky bashkëpunim dhe dialog nuk përjashton dhe nuk cenon aspak besnikërinë e çdo besimtari, kleriku, filozofi, shkencëtari, apo qytetari të thjeshtë ndaj parimeve të fesë së tij. Nuk është pra, aspak fjala për të shuar dallimet dhe diferencat në besime, sepse kjo do të na krijonte një botë uniforme shumë të trishtë, por është fjala për diçka tjetër, për atë parim të madh që personalitete të ndryshme e kanë shpjeguar aq bukur, pra të dialogut midis të ndryshmeve, të gjetjes së pikave të përbashkëta në diferencat në perceptimin e botës dhe të mistikes, të bashkëpunimit brenda dallimeve në perspektiva, të një hapësire publike të opinionit, ku secili duke ruajtur po të dojë edhe me fanatizëm parimet e botëkuptimit të tij të veçantë, di të shohë tek tjetri pika që i bashkojnë në një të tërë unike, që iu shfaqet në forma të ndryshme.

Sociologu i njohur Durkheim thotë:

“Meqë të gjitha fetë janë të krahasueshme, derisa janë lloje brenda së njëjtës gjini, detyrimisht disa elemente thelbësore i kanë të përbashkëta”¹⁵

dhe duke e vazhduar më tej mendimin e tij, autori nënvizon se,

“...feja është një gjë thellësisht shoqërore.”¹⁶

15. Durkheim, Emile, “Format elementare të jetës fetare”, Tiranë, 2000:20.

16. Po aty, 24.

Nisur edhe nga këto përcaktime, historia e bashkëjetesës ndërmjet shqiptarëve me përkatësi fetare të ndryshme, duhet vlerësuar si një fakt konkret, si një dukuri sa religjioze, po aq dhe shoqërore, si një formë e shprehjes së gjërave më thelbësore, të përbashkëta në universin fetar.¹⁷

Historiani italian Roberto della Rocca, në një referim të tij, shprehet:

“Pluralizmi paqësor fetar i Shqipërisë është një vlerë për vendin, për Ballkanin, për Evropën. Ai mund të jetë një model i bashkekzistencës në një Evropë me shumë fe, e cila ka vështirësi për të kuptuar enën e saj shkrirëse.”¹⁸

Në përmasat e pluralitetit fetar shqiptar vërehet qartazi se bashkekzistenca dhe harmonia fetare ndërmjet bashkësive fetare në Shqipëri bëhet më e lehtë për faktin, se ato lidhen edhe me disa karakteristika të veçanta, që kanë të bëjnë me shkallën e lartë të homogjenitetit të popullsisë, që ndan të njëjtat vlera kulture e gjuhe, pa përjashtuar diversitetin kulturor dhe subkulturat.¹⁹

Prania dhe bashkekzistenca e tre besimeve të popullit shqiptar: mysliman, ortodoks dhe katolik, ka bërë që toleranca ndërfitare të jetë një domosdoshmëri historike, duke shërbyer kështu, si mjet dhe faktor, që ka siguruar unitetin kombëtar dhe ekzistencën tonë si komb, megjithëse shqiptarët kurrë nuk e kanë ndarë përkushtimin fetar nga interesi kombëtar.

Në krijimin e një fryme tolerante, krahas besimeve fetare dhe përfaqësuesve të tyre ndër vite, ka ndikuar edhe trashëgimia socio-antropologjike e shqiptarëve, sistemi shoqëror tradicional dhe ai i vlerave.

Evropa duhet bërë të kuptojë se realiteti fetar i Shqipërisë është pasojë e historisë së veçantë të gadishullit ballkanik dhe s’duhet të jetë kurrsesi shkak për ta parë atë me dyshim. Islami në Ballkan është dhe duhet parë, si një pasuri kulturore dhe shpirtërore, pjesë përbërëse e historisë evropiane.²⁰

Harmonia ndërfitare është shfaqur si një përbërës i rëndësishëm i modelimit psikokulturor të shqiptarëve, duke kaluar drejt një vetëdije kombëtare për këtë vlerë.

E ruajtur thellë në ndërgjegjen e besimtarëve, gjatë regjimit komunist feja kishte humbur përkohësisht vetëm klerin dhe shfaqjen e saj të jashtme, ceremoniale. Sistemi

17. Gjoka, Rasim, “Tipologjia e konflikteve me natyrë fetare”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfitar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:83.

18 “Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri”, konferencë ndërkombëtare, Tiranë, 14-15 nëntor 2004.

19. Gjoka, R., “Tipologjia e konflikteve me natyrë fetare”, Tiranë, 2010:84.

20. Misha, Pirro, “Kombi, feja dhe globalizmi në Shqipëri”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfitar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konflikteve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:82.

monist nuk mundi të depërtonte deri në thellësi të shpirtave njerëzore. Kur ky sistem u përmbys, baza për ringjalljen e fesë ekzistonte e paprekur. Ajo u rishfaq me elegancë të pashoqe, duke rindërtuar me shpejtësi gjithçka, që ishte shkatërruar materialisht. Të persekutuar njësoj nga regjimi komunist, të gjitha besimet fetare u paraqitën me tiparet e tyre të plota doktrinare dhe rituale. Diversiteti fetar u rishfaq kështu fare natyrshëm. “Të ndryshmit” nga njëri-tjetri, ashtu si dikur, vazhduan të bashkëjetojnë në harmoni shembullore.

Përfundimi, që del nga kjo përjasje e shkurtër historike, është se diversiteti nuk zhduket dot artificialisht dhe herët a vonë, nxjerr krye për ta kujtuar këdo se është i pranishëm dhe se me të duhet me u marrë seriozisht. Rrjedhimisht, studimi i diversitetit në çdo fushë, përcaktimi shkencor i përmasave dhe karakteristikave të tij në shkallë kombëtare, komunitare dhe individuale, përbën një domosdoshmëri për të prodhuar më shumë tolerancë e mirëkuptim midis njerëzve në një shoqëri të hapur demokratike.

Në realitetin shqiptar, diversiteti fetar shfaqet si prodhues masiv tolerance, që e ka bazën pikërisht në pranimin pa kushte të faktit se “tjetri” është i ndryshëm, por jo i papranueshëm ose edhe armiqësor. Kjo nuk do të thotë se besimtarët e feve të ndryshme nuk kanë anë të përbashkëta, të cilat luajnë rol në harmoninë, që ata kanë midis tyre, por ato nuk duhen mbivlerësuar. Glorifikimi absolut i anëve të përbashkëta në procesin e praktikimit të tolerancës, sado që tingëllon bukur, në thelb nuk është produktiv, sepse mohon disi nevojën e përsosjes së vazhdueshme të dialogut ndërjetar, në një kohë që është ky i fundit ai që zotëron potencialin, për të zbuluar ngjashmëri të reja gjithmonë e më të thella.²¹

Harmonia ndërjetare, që ekziston në Shqipëri është fryti një ndërveprimi të shkëlqyer midis diversitetit dhe tolerancës. Ajo ka krijuar kushte të mrekullueshme për një dialog ndërjetar në nivel kapilar, nëpërmjet të cilit të realizohet njohja e ndërsjellë e “ndryshimeve” dhe pranimi i tyre si kusht për thellimin e këtij dialogu.²²

Mbështetur në historinë e këtij vendi, besnikëria ndaj harmonisë ndërjetare nuk mund të fiksohet vetëm tek toleranca fetare, por në një gjykim bashkëkohor të përbashkët të shqiptarëve, që d.o të thotë një gjykim qytetarie, barazi para ligjit, harmoni dhe solidaritet kombëtar, përfaqësim sa më i drejtë i komuniteteve fetare në strukturat civile, shpirt tolerance dhe mirëkuptimi mbi çështje të ndryshme të jetës së përditshme, etj..

21. Kule, Virgjil, “Pranimi dhe njohja e diversitetit-kusht për harmoni dhe dialog ndërjetar”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërjetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:104.

22. Po aty, fq. 112.

Përvoja e bashkëpunimit ndërjetar në Shqipëri

Në vitet e fundit bashkësitë tradicionale fetare në Shqipëri janë angazhuar në një sërë përpjekjesh për ruajtjen dhe forcimin e harmonisë fetare në vend. Këto përpjekje janë përkrahur edhe nga organizata e programe të huaja e ndërkombëtare, që përkrahin zhvillimin e dialogut dhe të bashkëpunimit ndërjetar në botë.

Forcimi i harmonisë fetare kërkon edhe një klimë të favorshme të jetës publike, ku diferencat fetare njihen, respektohen si vlera dhe nuk shihen si burime të diskutueshme konflikti. Projekti për “Përsosjen e vlerave të harmonisë fetare” përkrahu një sërë veprimtarish, që synonin në krijimin e një klime të tillë: prodhimin e filmave dokumentarë, që dokumentojnë vlerat e harmonisë fetare në vend dhe venë në pah të përbashkëtat e vlerave fetare në të rinj të besimeve të ndryshme, takime e trajnime me gazetarë e studentë, lehtësimin e dialogut mes udhëheqësve fetarë, gazetarëve dhe akademikëve, si dhe studime lidhur me marrëdhëniet ndërjetare në Shqipëri. Analiza e përvojës së programeve të përmendura më lart, por edhe të disa përpjekjeve të tjera, si p.sh. të një programi për kultivimin e dialogut ndërjetar në shkollat fetare në vend, tregon se përpjekje të tilla hasin në disa sfida.²³

Jeta shqiptare është shumëplanëshe. Pavarësisht nga laiciteti i shtetit, bota e fesë zë aty një vend të rëndësishëm me ndikime të gjera në plan kombëtar e ndoshta, për Shqipërinë, më shumë në plan ndërkombëtar. Nëse duam të promovojmë më tej, bie fjala, harmoninë ekzistuese ndërjetare, na duhet t’i njohim në detaje mjediset, ku ajo lind dhe zhvillohet. Këtu kërkohet kontribut nga media, por edhe nga komunitetet dhe institucionet fetare, të cilat duhet t’i bëjnë të ditur medias linjat themelore, ku ngjizet bashkëveprimi dhe harmonia brenda dhe midis tyre.

III.1. Aktivitete të dialogut ndërjetar në Shqipëri

Tashmë, që pas viteve 90-të, në Shqipëri janë organizuar shumë konferenca, simpoziume dhe aktivitete ndërjetare kombëtare dhe ndërkombëtare.

Krahas këtyre aktiviteteve ndër vite, mund të përmendet bashkëpunimi akademik dhe pedagogjik midis Universitetit “Bedër” në përgjithësi dhe të Departamentit të Shkencave Islame në veçanti, të cilët në një bashkëpunim ndërjetar midis tre teologjive në Shqipëri, asaj Islame në “Bedër”, Ortodokse, nëpërmejt Akademisë Teologjike Ortodokse, Shën Vlash, Durrës dhe Institutit Teologjik Katolik në Seminarin Ndërdioqezian, Shkodër, kanë hedhur hapa konkrete prej disa vitesh në këtë fushë.

23. Rrugë drejt dialogut ndërjetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010:51.

Kështu tashmë pas zhvillimit të seminareve dhe leksioneve të hapura të dialogut ndërfetar dhe shpjegimit teologjik të besimit të **secilit** me studentët e tri teologjive nga pedagogët e teologjive të ndërsjella, prej tre vitesh janë zhvilluar gjashtë simpoziume ndërfetare, të organizuara me radhë në tre institucionet arsimore, duke e kthyer këtë organizim në një traditë, që vazhdon me një periodik të caktuar, prej dy herësh në vit.

Këto organizime bashkëpunimi ndërfetar dhe shumë aktivitete të tjera të këtij lloji, e mveshin Universitetin “Bedër” me një specifike dhe mision të veçantë, të cilët kontribuojnë në paqen sociale në Shqipëri dhe përtej saj, si dhe janë garanci të ruajtjes, promovimit dhe forcimit të frymës së bashkëpunimit midis të ndryshmëve, si një pluralizëm multikulturor dhe multifetar, në një botë, që edhe pse çdo ditë e më tepër vjen e globalizohet, shtohen sfidat dhe problematikat për të ruajtur vlerat universale, që duhet të karakterizojnë një shoqëri të shekullit XXI.

IV. Në vend të mbylljes

Përkatësia multifetare e shqiptarëve e bën më të pasur dhe më të ndërlikuar identitetin kombëtar. Këtë e dëshmojnë të dhëna të panumërta të kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit shqiptar, por nuk ka dyshim se përkatësia multifetare, përpos se e bën më të pasur dhe më të përbërë, mund ta bëjë edhe më të plagosshëm identitetin kombëtar shqiptar, natyrisht, në qoftë se ndonjëra prej këtyre besimeve fetare do të favorizohej në mënyrë të veçantë prej institucioneve politike e shtetërore, siç veprohet herë pas here pas viteve ‘90-të.

Njëra prej dukurive më të vërejtura në jetën shoqërore të shqiptarëve sot, pa dyshim është shprehja e lirë e vetëdijes fetare, aq e penguar në kohën e komunizmit dhe kjo shprehje e lirë e vetëdijes fetare është fryt i çmuar i zhvillimit të demokracisë në shoqërinë tonë.

Shqiptarët, prej shekujsh jetojnë në udhëkryqin mes Lindjes e Perëndimit dhe janë ndikuar prej qytetërimit të Krishterë dhe atij Islam. Ndërthurja e kulturave të ndryshme e ka pasuruar kulturën shqiptare, duke e bërë të veçantë në rajon dhe në botë.

Literatura

“Fetë dhe qytetërimet në mijëvjeçarin e ri”, konferencë ndërkombëtare, Tiranë, 14-15 nëntor 2004.

Anamali, Skender, ‘Ilirët dhe shqiptarët’ në “E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”, 1990.

Bernatzik, Hugo Adolf, “Shqipëria-vendi i shqiptarëve”, botuar nga Uegen, Tiranë, 2003.

Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë, vëll. II, Tiranë, 1962.

Deklarata universale e të drejtave të njeriut.

Dervishi, Zyhdi; Fuga, Artan; Gjoka, Rasim; Kule, Virgjil; Misha, Pirro, “Fakte rrjedhëse të mirëkuptimit ndërfetar të shqiptarëve: një provë shpjegimore”, studime dhe vlerësime bashkautorësh, “Rrugë drejt dialogut ndërfetar në Shqipëri”, USAID, botuar nga “Fondacioni Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshjeve”, Tiranë, 2010.

Dervishi, Zyhdi. “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar”, Tiranë, Prizmi, 2008.

Durham, Edith, “Brenga e Ballkanit dhe vepra të tjera për Shqipërinë edhe shqiptarët”, Sh.N. “8 Nëntori”, Tiranë, 1990.

Durkheim, Emile, “Format elementare të jetës fetare”, Tiranë, 2000.

Ergene, Enes, parathënie, Gylen, “Drejt një qytetërimi botëror me dashuri dhe tolerancë”, Prizmi, Tiranë, 2005.

Kruja, Genti, “Shqiptarët përballë sfidave të mirëkuptimit ndërfetar”, Prizmi, Tiranë, 2008.

Moisiu, Alfred, Londër, 9.11.2005, fjalim; Loloci, C., gazeta “Trepça”, 4 gusht 2005.

Qosja, Rexhep, Gazeta “Korrieri”, 10 Shkurt 2006.

Ulqini, Karaman, “Faktorë kulturorë e fetarë”, Shkodër, 1999.

Xhufi, Pëllumb, “Shqipëria dhe bota mesdhetare në Mesjetë” (shk. XI-XIV), “Studime historike”, 2, 1990.

www.president.al, faqja zyrtare e Presidencës, 9.11.2005.

Tritan SHEHU¹

Universiteti Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë”

Bashkëjetesa ndërfitare, garanci për te sotmen e të ardhmen evropiane

Do të dëshiroja që këtë kumtesën time ta filloj me disa nga fjalët që Ati i Shenjtë ka thënë gjatë vizitës së tij në Tiranë:

“Faktet në Shqipëri dëshmojnë se bashkëjetesa paqësore dhe e frytshme mes personave dhe bashkësive, që u përkasin besimeve të ndryshme është jo vetëm ajo çka dëshirojmë, por konkretisht e mundur dhe e zbatueshme. Bashkëjetesa paqësore mes bashkësive të ndryshme fetare në fakt, është një pasuri e paçmueshme për paqen dhe për zhvillimin e harmonishëm të një populli... Uroj që Shqipëria të vazhdojë gjithnjë në këtë rrugë, duke u bërë një shembull frymëzimi për shumë vende të tjera!”

Dhe kjo është e vërtetë në shumë aspekte. Nëse kaloni në rrugët e Tiranës, mund të dëgjoni zërin e hoxhës që vjen nga minareja e Ethem Beut dhe tingujt e këmbanave të Katedraleve, të asaj Katolike të “Shën Palit”, apo të asaj ortodokse “Ngjallja e Krishtit”. Ndërsa pak më tej mbi disa kodra të bukura ndodhet Teqja e bektashinjve. Dikujt të ardhur prej vendesh me shumicë fetare të përcaktuar, kjo përplasje tingujsh e simbolesh mund t’i dukej çmenduri, gati-gati blasfemi.

Por fatmirësisht për ne shqiptarët përplasja e simboleve nuk shkon aq larg sa të çojë në përplasjen midis njerëzve, që i interpretojnë apo i marrin të mirëqena këto simbole. Kjo është transmetuar vazhdimisht midis nesh, brenda e jashtë vendit, në shekuj, në paqe e në luftë dhe padyshim ka marrë një vlerë të veçantë në vitet tona të demokracisë. Për ne është ashtu siç tha në Universitetin Katolik “Zoja e Këshillit të Mirë” Papa Françesko:

“Besimi autentik është burim paqeje dhe jo dhune! Askush nuk mund të përdorë emrin e Zotit për të ushtruar dhunë! Të vrasësh në emër të Zotit është një sakrilegj i madh! Të diskriminosh në emër të Zotit nuk është njerëzore.”

1. Nënkyetar i Komisionit të Politikës së Jashtme në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Kjo tolerancë fetare që karakterizon popullin tonë mbështetet në faktin se në themel të këtij virtyti nuk ka “zbrazëti”. Në themel të tij qëndron dialogu, apo mbi të prodhohet dialog, dinamik ky për hapa të tjerë konsolidimi e konkretizimi. Dhe këtu unë do të doja të citoja atë çfarë ka thënë Papa Vojtila:

“Liria e vërtetë fetare i shmang tundimet e intolerancës e sektarizmit dhe nxjerr në pah qëndrimet e respektit e dialogut konstruktiv.”

Pa dyshim një shoqëri e tillë tolerante nuk ka ardhur kaq lehtësisht. Sidoqoftë sot askush nuk mund të japë siguri të plotë nëse ka për të vazhduar të jetë përherë e njëjtë, në një shoqëri botërore të trazuar, në qoftë se nuk do të kuptohet qartë thelbi i saj dhe nuk do të ecet me shpejtësi në rrugën, që e konsolidon këtë ambient paqësor. Këtu një vend parësor zë dialogu i hapur ndërfaqësor, apo dhe më gjerë, i bazuar mbi interesat madhore të vendit e popullit tonë, duke i bërë kështu komunitetet fetare, jo thjesht grupime paqësore pasive, por motorë të vërtetë bashkëjetese, stabiliteti, mirëqenieje, vizioni evropian e perëndimor.

Në Shqipëri gjenden 4 komunitete tradicionale fetare: Komuniteti Mysliman, Komuniteti Ortodoks, Komuniteti Katolik e ai Bektashi.

Në kushtet aktuale të zhvillimit dhe emigracionit të Shqipërisë statistikisht numerike për secilin besim duhen marrë me rezerva. Së pari, sepse asnjëra prej tyre nuk u referohet numrit të praktikanteve të feve respektive. Së dyti, sepse dhe në vetë përkatësinë fetare të njerëzve ka një dinamikë ndryshuese. Së treti, se referimi që bazohet mbi emrat nuk është i saktë. Së katërti, të mos harrojmë se në Shqipëri martesat midis partnerëve me fe të ndryshme janë të zakonshme. Kështu ky realiteti nuk është statik. Kjo është një tjetër shprehje e tolerancës dhe e diçkaje më thelbësore që na bashkon, që është të qenit shqiptar. Nga ana tjetër, aktualisht rreth 40% e popullsisë sonë jetojnë jashtë vendit, kryesisht në vendet evropiane të BE, veçanërisht në Itali e Greqi. Një pjesë tjetër në SHBA e Kanada. Ne shqiptarët kemi një veti e aftësi të veçantë integrimi në shoqëritë e zhvilluara perëndimore ku jetojmë, padyshim duke ruajtur dhe karakteristikat tona, por asnjëherë këto nuk na bëjnë të jetojmë të mbyllur e izoluar aty, sepse në fakt edhe këto janë qartësisht të përputhshme me ato realitete. Ne nuk dëshirojmë të qëndrojmë aty të marginalizuar, por përpiqemi të jemi pjesë e tyre. Ky është një aset tejet pozitiv për një popull, i cili lidhet edhe me tolerancën tonë të thellë fetare të brendshme, si dhe me përkatësinë e aspiratën tonë të palëkundur perëndimore. Padyshim dhe ky fenomen ndikon jo pak në fluktuacionet e numrit të besimtarëve për çdo fe.

Megjithatë kjo nuk do thotë aspak se nuk ekziston identiteti i komuniteteve fetare të ne. Ai identitet ekziston dhe mbi apo nëpërmjet tij është vendosur dialogu dhe

bashkëjetesa fetare. Këtu unë do të perifrazoj përsëri nga çfarë tha Papa Françesko në Tiranë:

“Do të doja gjithashtu të theksoja diçka që ka mbetur fantazmë: relativizmi... Lidhur me këtë duhet të mbajmë parasysh gjithnjë një parim të qartë: nuk mund të dialogosh nëse nuk nisesh nga identiteti yt. Pa identitet nuk ka dialog. Do të ishte një dialog fantazme, një dialog në ajër: nuk shërben për asgjë.... është relativizëm. Ajo që na bashkon është rruga e jetës, është vullneti për t’u nisur nga identiteti ynë për t’u bërë mirë vëllezërve dhe motrave.”

Dhe pikërisht ky dialog, që mbështetet mbi identitetin fetar të secilit, kërkon edhe të ruajë identitetin thelbësor për në, atë të të qenit shqiptar, atë evropian. Pra parvarësisht nga shifrat e besimtarëve dhe feja që i përkasin ata, aspirata e plotë e shqiptarëve, e mbi 97% e tyre, është Evropa, Perëndimi. Ky është realiteti shqiptar nën këtë këndvështrimi, gjë që tregon se jashtë raporteve numerike, bashkëjetesa fetare dhe dialogu ndërjetar për ne është një realitet i pamohueshëm, i ndërtuar mbi vizione konkrete.

Si është arritur deri këtu? Në fakt ne kemi një histori fetare të gjatë, me “furtuna” disa herë.

Shqiptarët fenë e parë të tyre, të krishterën, e përqafuan me vetëdije përpara se dhe shumë popuj të tjerë. Feja e krishterë për paraardhësit tanë ishte më autoktonia, sepse ajo është apostolike, e ardhur ndër Ilirët e lashtë përmes fjalës së apostujve. Apostulli Pal, rreth viteve 42-49 shkruan:

“Kështu prej Jerusalemit e përqark e deri në Iliri kam kryer shërbimin e ngjalljes së Krishtit, duke u përpjekur të ungjillizoj atje ku nuk ishte i njohur emri i Krishtit.”

Në shekujt e tjerë, sipas shumë studiuesve Shqipëria ka qenë një urë kalimi e përhershme midis Lindjes e Perëndimit. Në të vërtetë ne kemi qenë në periferi të tri perandorive: asaj romane, bizantine e otomane, por duke i përkritur gjithmonë Perëndimit në aspirata, mentalitet e realitet. Noli dhe Konica thonë se shqiptarët që i përkisnin kishës katolike ishin katolikët e vetëm të Perandorisë Bizantine. Pra, megjithëse diku shkruhej se në trutë e çdo shqiptari ka një “vijë të Teodosit që rishfaqet” në të gjitha ngjarjet e dilemat e mëdha, nuk na ka penguar të zgjedhim, atëherë kur kemi pasur mundësi të zgjedhim, veçse Evropën.

Më tej vjen periudha e gjatë e pushtimit otoman, e largimit tonë për gati pesë shekuj prej familjes sonë natyrale, asaj evropiane.

Në këtë periudhë sundimi, një pjesë e madhe e shqiptarëve u konvertuan në myslimanë dhe kjo kryesisht në zonat e Shqipërisë së mesme.

Po kështu, duhet të kujtojmë se në Shqipëri u vendos dhe Kryegjyshata Botërore Bektashiane, që paraqitet si një formë e afrimit të myslimanizmit me perëndimin e kristianizmin, si një dëshmi tjetër e tolerancës sonë fetare.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore Shqipëria tregoi e manifestoi një nivel akoma më të lartë të kësaj bashkëjetese dhe hapjeje, dy herë radhazi. Në fillim të asaj Luftë në vendin tonë jetonin rreth 200-300 hebrenj, kryesisht në qytetet kryesore. Në fund të Luftës numri i tyre kishte arritur në rreth 3000, të ardhur edhe rishtazi nga vendet përrreth për t'u shpëtuar masakrave. Asnjë nga ata nuk iu dorëzua nazistëve. Popullsia shqiptare i fshehu, padyshim nën rrezik. E njëjta gjë ndodhi edhe me ushtarakët italiane, mbas kapitullimit të Italisë fashiste, kur ata në shumicën dërmuese, me mijëra e mijëra, u morën nën mbrojtje dhe jetuan të strehuar në ilegalitet në familjet shqiptare. Dhe në këto procese të katërta komunitet fetare së bashku ishin pjesë aktive e mbështetëse, ashtu siç ishin edhe në tërësi për luftën tonë antifashiste.

Mbas Luftës së Dytë Botërore vendi ynë pati fatkeqësinë të jetë pjesë e perandorisë komuniste, të njohë një nga diktaturat më kriminale, të largohet përsëri nga Perëndimi e të jetë i vetmi vend në botë i ateizmit të detyruar edhe nëpërmjet Kushtetutës. Në këtë periudhë terrori pa asnjë dyshim komuniteti që “pagoi çmimin më të lartë” ishte ai katolik, me martirizimin e tij ekstrem. Por sidoqoftë asnjë nga komunitetet tona fetare nuk u kthye në vegla të komunizmit dhe të gjithëve së bashku iu ndalua çdo aktivitet prej vitit 1967.

Pra një histori jo e lehtë kjo jona. Por me gjithë këto ngjarje, kontradikta dhe këtë kompleks realitetesh, feja në përgjithësi te ne ka qenë kurdoherë një aleate e pashtershme jo vetëm e dashurisë për vendin, por dhe në pjesën dërmuese një shtytëse drejt Perëndimit. Ajo nuk ka qëndruar kurrë në vetvete, si përpjekje për të legjitimizuar këtë, apo atë doktrine fetare, ajo ka patur një vlerë të matshme pragmatike: mbijetesën e kombit shqiptar, përkatësinë tonë evropiane.

Kështu p.sh. katolicizmi ka ndihmuar mbijetesën që nga lashtësia romake, ortodoksizmi nga ajo bizantine, myslimanet e bektashinjtë kanë patur pjesën e tyre ndihmuese të rëndësishme, kur Shqipëria u bënte ballë sulmeve asimiluese. Dhe të gjitha këto, si shpesh herë u bashkuan, që te rilindte Shqipëria më 1912, për t'u shkëputur nga Perandoria Otomane e për t'u bërë e pavarur. Pavarësia do të sillte në mënyrë të pashmangshme largimin nga Lindja, rilidhjen me ambientin tonë natyral, Evropën. Përpjekjet, që ka bërë Kisha Katolike me emra të tillë si Pal Engjëlli, Gjon Buzuku, Pjetër Budi, Mjeda, Gjergj Fishta etj, apo ajo Ortodokse me emra si Papa Kristo Negovani, Petro Nini Luarasi, Grameno, Fan Noli, Komuniteti Mysliman e Bektashi me Hoxha Tahsinin, vëllezërit Frashëri etj. kanë realizuar një evolucion të thellë kulturor e moral te ne në vite. Këta janë nga figurat kryesore edhe të kulturës së shkruar shqipe, elaboruesit e gjuhës sonë me germa latine.

Më tej e njëjta tablo u përsërit më 1990, vit i shembjes së komunizmit, kur rilindja e demokracisë dhe e aspiratës përëndimore, u shoqërua edhe me ringjalljen e besimeve fetare. Të krishterë, myslimanë e bektashinj së bashku, jo vetëm që u përfshinë në lëvizjen antikomuniste, por dhe klerikët e tyre të bashkuar organizuan ceremonitë e para fetare, rihapën krah për krah njëri-tjetrit institucionet e kultit.

Dhe qartësisht në këto 26 vite demokraci përsëri së bashku, ashtu siç u manifestua edhe gjatë vizitës së Papa Françeskos në Shqipëri, ecëm në përmbylljen e aspiratës sonë, jo vetëm për konsolidimin e shtetit demokratik e laik, por dhe të rrugës sonë drejt familjes evropiane.

Ndoshta kjo formulë, që lidh fenë me atdhetarizmin dhe përkatësinë evropiane të vendit, është në gjenezën e dialogut të suksesshëm dhe të bashkëjetesës fetare për ne shqiptarët.

Por kjo nuk mbaron vetëm këtu. Fetë midis nesh shkojnë shumë mirë së bashku dhe për të mbrojtur me vendosmëri, gjithmonë brenda tolerancës së tyre, vlerat thelbësore morale të shoqërisë si vlera universale. Dhe këtu ka diçka të veçantë, të çmuar, që ekziston me familjen, familjen dhe fëmijët, në edukimin e rritjen e tyre të “shëndetshëm” jo thjesht fizike. Familja për ne është e shenjtë, dhe me këtë kuptojmë vlerat poliedrike të saj, padyshim duke filluar nga koncepti thelbësor, që është bashkimi me të drejta krejt të barabarta i një burri me një grua, me shpresë për fëmijë. Kjo është një pikë tjetër bashkimi, që jo vetëm lehtëson dialogun ndërjetar te ne, por dhe që e konkretizon më fort atë, në sinkroni të plotë edhe me opinionin e gjerë popullor. Në fakt ky vizion për familjen është një tjetër garanci e rëndësishme për ruajtjen e zhvillimin dhe të vetë bashkëjetesës sonë fetare. Nga ana tjetër, një gjë e tillë ka forcuar ndjeshëm premisat në vendin tonë për ekzistencën e një legjislacioni adekuat dhe në përputhje me këtë frymë, që kërkon të mbrojë vlerat universale të shoqërisë. Dhe këtu në radhë të parë unë nënkuptoj Kodin e Familjes, Ligjin për Birësimet, si dhe atë kundër Diskriminimit, ligje këto të mbështetura pothuajse unanimitisht në Parlament.

Pra në rrugën e tyre, me instinktin për mbijetesë, shqiptarët kanë një përputhje në ekzistencë me thëniet e Papa Gjon Pali II:

“Qeniet njerëzore... që prej lindjes, ato janë të zhytur në traditat, të cilat u japin atyre jo vetëm një gjuhë dhe një formim kulturor, por edhe një sërë të vërtetash në të cilat ata besojnë pothuajse instinktivisht. Megjithatë, rritja dhe pjekuria personale të thotë se këto të vërteta mund të vihen në dyshim dhe të vlerësohen nëpërmjet një procesi verifikues kritik.”

Dhe pikërisht këtë proces vetëpërsosjeje shqiptarët mundohen ta arrijnë me mosmbylljen brenda homogjenitetit të të qenit kështu apo ashtu, vetëm dhe esencialisht, por përkundrazi me të qenit të hapur drejt të ndryshmes, për ta pranuar dhe për

të marrë e dhënë me të. Por gjithmonë duke ruajtur atë çfarë ne kemi më të çmuar, identitetin tonë si shqiptarë, si evropianë, vlerat tona thelbësore, si pikat e dialogut midis nesh. Në këtë përpyetje shqiptarët thuhet se zbatojnë, pa ditur se ekziston atë çfarë është thënë në Këshillin e Dytë të Vatikanit:

“Kisha Katolike nuk hedh poshtë asgjë që është e vërtetë dhe e shenjtë në këto fe. Ajo i përshëndet me nderim të sinqertë këto mënyra të sjelljes dhe të jetesës, ato rregulla dhe mësim të cilat, ndonëse të ndryshme në shumë aspekte nga ato që ajo mban dhe përcakton, shpesh reflektojnë një rreze të asaj së Vërtete, që ndriçon të gjithë njerëzit.”

Por jo vetëm kaq. Ne duke qenë edhe i vetmi popull në botë që përjetuam sanksionimin me kushtetutë të mohimit të ushtrimit të kultit për të jetuar si ateistë, shtohet dhe një dimension tjetër në debatin ndër-religjioz.

Kështu, marrëdhëniet ndërfetare për ne nuk reduktohen vetëm tek dialogu midis feve monoteiste, por dhe tek dialogu i fesë dhe jofetarëve, që do të thotë mes besimtarit dhe ateistit. Kjo e bën edhe me substanciale frymën e mirëkuptimit, duke i zgjatur dorën edhe atij që nuk beson.

Pra dialogu fetar dhe kuptimi ndërfetar është i gjerë dhe i qenësishëm në Shqipëri. Duhet bërë çmos për ta ruajtur dhe përdorur të tillë atë, në një rajon të trazuar siç është Ballkani. Dhe sot mjeti më i sigurtë për ta ruajtur e zhvilluar këtë pasuri është përshpejtimi i atij procesi vlerash e standardesh, që krahas ndjenjës kombëtare, ka qenë e është në themel të aspiratës sonë, pavarësisht “vijës së dikurshme të Teodosit” dhe që quhet integrim evropian. Pa asnjë dyshim, një garanci e veçantë për ne dhe për ata që vendosin hapat dhe ritmet e integritit tonë evropian është pikërisht toleranca e bashkëjetesa shembullore fetare që ne kemi. Këtë e konfirmojnë dhe fjalët e Papa Françeskos në kthim mbas pritjes madhështore që iu bë këtu:

“Shqipëria është një vend evropian. Për mua kjo ka qenë një surprizë. Shqipëria është një vend evropian, pikërisht për kulturën – kulturën e bashkëjetesës dhe për kulturën historike që ka patur.”

Prof. Dr. Xhezair TELITI
 Rektor i Kolegjit Universitar “Logos”

Harmonia dhe bashkëjetesa fetare, një model i domosdoshëm në procesin e edukimit të të rinjve të sotëm

Harmonia dhe bashkëjetesa fetare që fatmirësisht ka ekzistuar dhe ekziston në vendin tonë është një dhuratë e çmuar që historia na e ka falur dhe ruajtur ndër shekuj. Harmonia dhe bashkëjetesa fetare nuk janë një dukuri e ditëve tona. Ajo është një traditë e hershme, e cila dëshmohet me dokumente të gjetura dhe shkrime letrare të periudhave jo shumë të afërta kohore. Evidentime të kësaj dukurie gjejmë që në mesin e dytë të shekullit XIX-të. Në një botim të fundit (2016) mbi “Tolerancën fetare” me autor Kahreman Ulqinin, gjejmë vlerësime të dhëna nga një autor i huaj i kësaj periudhe, sipas të cilit ‘në zonën e Matit e të Mirditës ka hakmarrje gjaku, por asnjëherë nuk ka patur grindje fetare’.

Po ashtu, në vitin 1878, rilindasi i njohur Abdyl Frashëri thekson se në asnjë vend të botës nuk gjenden njerëz të besimeve të ndryshme, që jetojnë në miqësi dhe në harmoni të tillë siç jetojnë shqiptarët myslimanë e të krishterë. Madje, vazhdon ai, as në kohën e barbarizms më të thellë nuk janë shënuar në Shqipëri grindje, luftëra dhe as masakra të shkaktuara për dallime fetare.

Janë të shumtë studiuesit e fushave shoqërore që, me fakte dhe argumente të mbështetura në vlerësime shkencore historike, evidentojnë Shqipërinë si një vend i veçantë, që e ka transmetuar bashkëjetesën fetare jo vetëm si një vlerë e rrallë me të cilën krenohet, por edhe si një nevojë konstante për të mbijetuar dhe përballuar bashkarisht sfidat e ndryshme, të cilat na ka prezantuar historia jonë e ngarkuar jo pak herë me ngatërresa të ndryshme brenda dhe jashtë vendit tonë.

Bashkëjetesa paqësore e komuniteteve fetare ka shërbyer në çdo kohë si një nevojë bashkimi dhe në momente të rëndësishme të vendit tonë.

Bashkarisht të krishterë dhe myslimanë kanë luftuar për pavarësinë tonë kombëtare dhe për çlirimin e vendit. Në dokumentin që Ismail Qemali u dërgoi shteteve të rëndësishme të kohës (Itali, Austri-Hungari, Francë, Britani e Madhe, Rusi dhe

Gjermani) për shpalljen e Pavarësisë përmendej se Asambleja Kombëtare e përbërë prej delegatësh nga gjithë Shqipëria, pa dallim besimi, proklamoi independencën politike të Shqipërisë. Nga ana tjetër dhe përbërja në përqindje të njëjtë sipas besimeve fetare e anëtarëve të qeverisë së parë pas pavarësisë së vendit është një dëshmi e faktit se mbrojtja kombëtare dhe progresi i vendit kanë qenë parësore dhe momente bashkimi të përgjegjshme të komuniteteve tona fetare, pa evidentuar besime fetare mbizotëruese apo në pakicë.

Populli shqiptar ka gjetur, jo në pak momente kohore, tek besimet dhe komunitetet e ndryshme fetare mesazhet e afrimit ndërfejar: mesazhin e paqes, nevojën për të qenë pranë njëri-tjetrit dhe ndihmesën ndaj më të dobët etj. Këto mesazhe kuptimplote, të përçuar në vite, kanë një vlerë aktuale edhe tani dhe si të tilla duhen ruajtur dhe inkurajuar, sepse ato synojnë kultivimin e vlerave pozitive sociale shumë të nevojshme për individin e ri në shoqërinë tonë. Mesazhi i ndihmës dhe i mbështetjes reciproke, pa dallim feje, që është evidentuar tek shqiptarët në raste vështirësish, apo në fatkeqësitë e ndryshme natyrore, është nga njëra anë një shprehje konkrete e cilësive shumë pozitive të kultivuara brez pas brezi në familjet shqiptare, por nga ana tjetër është dhe një shprehje e mirëkuptimit dhe e harmonisë fetare që ekziston midis vetë shqiptarëve.

Autorë të shumtë evidentojnë harmoninë fetare si një vlerë e çmuar e vendit tonë. Ky vlerësim është i rëndësishëm jo vetëm se evidentohet si karakteristikë pozitive që na nderon ne, por gjykoj se në kushtet e vendit tonë ajo përbën sot një model të domosdoshëm në edukimin e të rinjve tanë.

“Harmonia fetare, - thekson I. Kadareja, - sa ç’është madhështore si ngrehinë, është dhe aq e brishtë. Mjafton e çara e parë serioze, mjafton radikalizimi i njërit prej besimeve, që ngrehina të shembet. Neve nuk na lejohet, - apelon ai, - asnjë sjellje e papërgjegjshme dhe asnjë pakujdesi në mirëmbajtjen e kësaj ngrehine. Aq më pak nuk na lejohen pasionet mesquine provokuese.”

Është detyra jonë e përbashkët, që secili në pozicionin dhe detyrën e tij të bëjë, që kjo ngrehinë madhështore, në rastin e vendit tonë, të mbahet në këmbë fuqishëm.

Sot në vendin tonë ushtrojnë veprimtarinë e tyre shumë besime të tjera fetare: myslimanë, ortodoksë, katolikë, bektashinj, protestantë, ungjillorë, baptistë etj., të cilat aktualisht bashkëjetojnë në respekt reciprok me besimet e tjera.

Është fakt që sot kemi një numër jo të vogël të rinjsh, të cilët janë afruar me besimet fetare nëpërmjet angazhimeve direkte ose riteve dhe ceremonive të ndryshme. Ky afrim është i rëndësishëm në edukimin e individit, sepse shoqërohet me kultivimin e ndjenjës për të qenë i motivuar dhe gjithmonë me besim e shpresë në jetë. Për mbi të gjitha, në këto rite fetare, promovohet ndjenja e respektit dhe e mbështetjes për të tjerët. Gjykojmë se është me vlerë shumë edukative, që kjo ndjenjë të mos kufizohet vetëm për individë të të njëjtit besim, por të shtrihet edhe për individë të besimeve tjera.

“Një Perëndi kemi, - shkruan rilindasi Naim Frashëri, - gjithkush çdo besim të respektojë fenë e tij dhe fenë e tjetrit e të mos bëjë dallim feje. I mënçuri dhe i urti është besimtar, ai nuk është fanatik për besimet dhe ai nuk ndan paragjykime.”

Në ditët që po kalojmë është me shumë vlerë edukative fakti që asnjë besim fetar të mos promovojë tek të rinjtë e vet, që ka rreth vetes, epërsinë e tij ndaj besimeve të tjera. Çdo besim ka historinë e tij të krijimit dhe fazat e tij të zhvillimit, por është shumë domethënës fakti që besimet fetare, pavarësisht dallimeve që kanë, ato promovojnë paqe dhe një bashkëjetesë më me mirësi, dashuri e shpresë.

Në një takim me studentë të Kolegjit Universitar “Bedër”, ambasadori aktual i SHBA-ve në vendin tonë, prezantoi një model të bashkëjetesës fetare në rrethin e vet familjar, ku babai i tij, ai dhe kunati i tij kishin besime jo të njëjta dhe secili prej tyre respektonte reciprokisht besimin dhe ritet fetare të tjetrit. Për bashkëjetesën fetare në familje kemi shumë shembuj dhe në vendin tonë jo vetëm tani, por edhe më parë.

Autori Kahreman Ulqini në librin e tij mbi tolerancën fetare evidenton se në Kodikun e Mitropolisë së Drinopulit të vitit 1892 janë shënuar martesat e lidhura midis ortodoksëve dhe myslimanëve.

Modelin e bashkëjetesës fetare në familje e përjetojmë edhe tani në qytete të ndryshme të vendit tonë, ku shumë familje janë formuar dhe vazhdojnë të formohen me bashkëshortë me besim jo të njëjtë fetar dhe është bërë traditë e bukur, që pjesëtarët e familjes të festojnë bashkarisht festat fetare të secilit bashkëshort. Ky është një shembull pozitiv në edukimin e fëmijëve tanë, të cilët duhet të rriten me ndjenjë e respektit dhe jo me atë të nënvlefësisimit dhe aq më keq me atë të urrejtjes.

Ne përjetuam mohimin e besimit fetar për shumë vite. Ringjallja e besimeve fetare dhe kujdesi i bërë nga këto besime për të rindërtuar institucionet e kultit

(kisha, xhami dhe teqe) mundësoi një afrim të shpejtë të fëmijëve dhe të rinjve shqiptarë pranë këtyre institucioneve. Ky fakt ndikoi që në edukimin e tyre, krahas familjes dhe shkollës, një peshë të veçantë të rizë edukimi fetar i fituar nëpërmjet institucioneve të besimit.

Bashkëjetesa fetare bëhet më shumë e qëndrueshme, kur vetë drejtuesit e besimeve fetare e mbështetin atë. Shembulli i ditëve të fundit gjatë vizitës së Patriarkut të Moskës dhe i gjithë Rosisë, Fortlumturisë së tij Kirilli në vendin tonë, me ftesë të Kryepeshkopit të Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, dëshmoi se aktualisht drejtuesit e komuniteteve tona fetare e mbështetin personalisht bashkëjetesën fetare. Përbën një moment shumë domethënës fakti që në tryezën kryesore të drekës së pritjes me këtë rast, dy figurat e larta të besimit ortodoks ishin rrethuar nga drejtuesit kryesorë të besimeve: mysliman, katolik dhe bektashi. Për më tepër, po aq domethënës është fakti, që të dy autoritetet e larta fetare në fjalën e tyre u kushtuan rëndësi vlerave, që ka bashkëjetesa fetare në çdo moment kohor.

Theksimi i domosdoshmërisë për të jetuar dhe punuar në harmoni dhe bashkëjetesë fetare, si dhe orientimi i individit drejt mirëkuptimit dhe tolerancës fetare kushtëzohet dhe nga rezultati i censusit zyrtar, i organizuar në vitin 2011, i cili evidentoj se më shumë se 85 % e popullsisë shqiptare e deklaroi veten si “besimtarë” dhe vetëm 2.53% si “ateistë”. Në shifrën 85 % përfshihen familje me besime jo të njëjta fetare, që padyshim i afrojnë fëmijët e tyre që në moshë të vogël, ndoshta pa u futur ende në shkollë, drejt besimit përkatës.

Dhe padyshim në procesin e edukimit të mëtejshëm të këtyre fëmijëve, shkolla ka një rol të veçantë. Për këtë arsye ajo mbart si një përgjegjësi institucionale ruajtjen, kultivimin dhe përçimin e vlerave më të mira sociale. Kjo përgjegjësi institucionale merr një vëmendje të veçantë jo vetëm në nivelin arsimor 9-vjeçar, por edhe atë të mesëm, ku individit formohet me vlerat bazë të edukimit qytetar.

Vendimi i fundit i qeverisë për të konceptuar një projekt pilot të përfshirjes së edukatës fetare në shkollë është një moment i vlerësueshëm, jo vetëm për kulturën informuese që siguron, por edhe për kontributin e veçantë që jep në konsolidimin tek moshat e reja të mënyrës së të jetuarit në harmoni dhe në bashkëjetesë fetare në vendin tonë. Synimi, që mbart ky projekt është që përveç prezantimit të një kulture njohëse mbi historitë e formimit të besimeve fetare, të sigurohet edukimi i nxënësit “larg informacioneve, që përcjellin sjellje ekstreme fetare”. Suksesi i këtij projekti, i cili është në fillimet e tij, kushtëzohet ndjeshëm nga drejtpeshimi i opinioneve dhe konsideratave fetare në programet mësimore të ndërtuara për këtë projekt. Ai plotëson një nevojë të munguar për nxënësit tanë, sepse me anën e tij mundësohet

jo vetëm një edukim kulturor - informativ, por dhe një edukim social i individit, shumë i nevojshëm për të jetuar dhe punuar në mjediset dhe komunitete të përbas-hkëta.

Edhe shkollat e larta publike dhe jopublike në vendin tonë, pavarësisht karakterit dhe specifikave të tyre profesionale, kanë mundësi institucionale për të krijuar hapësira dhe praktika, që synojnë të mos çënojnë sadopak harmoninë dhe bashkëjetesën fetare në mjediset e tyre.

Aktualisht është një detyrim i institucioneve universitare që të sigurojnë një mjedis të përshtatshëm arsimor, ku të studiohet e të punohet për një përgatitje profesionale dhe kulturore.

Në Kolegjin Universitar “Logos” bëhet një kujdes i posaçëm, që në punën e përditshme të personelit pedagogjik dhe të studentëve tanë të mos ndikojë sadopak mendimi që presidenti i kësaj shkolle është drejtuesi më i lartë i besimit fetar ortodoks. Brenda hapësirave ligjore që siguron legjislacioni në fuqi, në këtë institucion bëhen përpjekje konkrete që në auditorët, laboratorët dhe mjediset e institucionit të mbizotërojnë respekti reciprok, pavarësisht nga besimi që mbart.

Detyrimin institucional për ruajtjen e harmonisë dhe bashkëjetesës fetare personeli akademik dhe ai drejtues i Kolegjit Universitar “Logos” përpiqet ta realizojë në disa drejtime:

Së pari:

- në ndërmarrjen e iniciativës për të ndërtuar programe mësimore, që ndihmojnë në përgatitjen e ekspertëve me njohuri teorike dhe praktike për mbrojtjen dhe ruajtjen e objekteve të trashëgimisë kulturore religjioze të Shqipërisë (restaurime, studime promovuese, muze, galeri, veprimtari artistike etj.).

- në përgatitjen e kuadrove të formuar me njohuri teologjiko-sociale, të cilët të jenë të aftë për të shërbyer dhe për të punuar në organizma sociale, kulturore dhe religjioze, pranë organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe institucioneve kërkimore.

Së dyti:

- në kujdesin konstant për ruajtjen e respektit reciprok ndërfetar midis studentëve që studiojnë në institucionin tonë dhe anëtarëve të personelit akademiko – administrativ, që drejton këtë institucion.

Në Kolegjin Universitar “Logos” ka studentë, që vijnë nga krahina, apo qytete të ndryshme dhe me besime jo të njëjta fetare: myslimanë, ortodoksë dhe katolikë. Të gjithë respektohen njëllon në përputhje me legjislacionin arsimor në fuqi. Ata sipas meritës, shpërblehen njëllon me bursa mbështetëse për rezultate të larta në procesin mësimor, pavarësisht nga përkatësia e besimit.

Autoritetet drejtuese në kolegji: rektori, dekanë dhe përgjegjës të njësive bazë kanë një shpërndarje besimi: 50 % të krishterë dhe 50 % myslimanë, madje dhe vetë rektori, si drejtues i një institucioni me mbështetje fetare ortodokse, është mysliman.

Së treti:

- në përfshirjen e studentëve në veprimtari konkrete, që promovojnë ndjenjën e solidaritetit njerëzor, siç janë veprimtaritë që mundësojnë mbështetje materiale dhe financiare, sadopak modeste, për shtresat në nevojë. Aktualisht në Kolegjin Universitar “Logos” ka një gatishmëri të mirë dhe mjaft sensibilitet, si nga studentët, ashtu dhe nga personeli pedagogjik për t’iu përgjigjur thirrjeve të organizatave, që kanë mision të tillë, si Kryqi i Kuq Shqiptar, fondacioni për ushqimin Bank Food, etj.

Së katërti:

- në lidhjen shumë bashkëpunuese që Kolegji Universitar “Logos” ka me dy universitetet jopublike “Bedër” dhe “Zonja e Këshillit të mirë”, i pari me mbështetje institucionale nga Komuniteti Mysliman i Shqipërisë dhe i dyti me mbështetje institucionale nga Kisha Katolike. Ne kemi pjesëmarrje reciproke në aktivitete studentore të njëri-tjetrit, madje me universitetin “Zonja e Këshillit të mirë” kemi marrëveshje bashkëpunimi dhe organizime të përbashkëta të konferencave ndërkombëtare shkencore. Pjesëmarrja dhe cilësia shkencore në ngritje e pedagogëve të këtij kolegji në këto konferenca ndërkombëtare, si dhe gatishmëria për bashkëpunim i trupave drejtuese nga të dy këto universitete është një dëshmi domethënëse dhe konkrete e respektit të një komuniteti fetar ndaj një komuniteti tjetër.

Bashkëpunimi reciprok është vlerësuar shumë nga institucionet tona, sepse bashkarisht e kemi konceptuar atë si një detyrë që ka rëndësinë e vet në procesin e edukimit profesional dhe social të studentëve tanë. Bashkarisht ne kemi gjukuar se është detyrim i institucioneve tona të edukimit, që në punën edukuese të gjejmë atë që na bashkon dhe jo atë që na ndan. Të mos harrojmë se historia jonë mbart shumë evenimente motivuese për të gjetur se çfarë na bashkon.

Historia jonë sjell shembullin e rilindasve tanë, të cilët luftuan me patriotizëm e të bashkuar pa dallim feje për pavarësi dhe zhvillim kulturor.

Historia jonë dëshmon se kombformimi shqiptar është mbështetur bashkarisht nga të gjitha besimet e ndryshme fetare, që në kohërat e hershme, duke e kuptuar domosdoshmërinë e një kombi të shëndoshë e të qëndrueshëm për një ecuri më normale të vetë këtyre besimeve.

Historia jonë sjell shumë shembuj sakrificash jetësore në shërbim të humanizmit njerëzor, në veçanti historia na sjell shembullin e Nënë Terezës - Gonxhe Bojaxhiut të Shqipërisë, gruas së famshme në botën e sotme, e cila sakrifikoi jetën e saj në ndihmë të njerëzve në pamundësi kudo në rruzullin botëror, pa u interesuar për besimin fetar, që ata mbartin.

Historia jonë mbart faktin e pamohueshëm se familjet shqiptare në shekuj, kanë qenë shembull për çdo popull në botë, i kapërcimit të vështirësive të bashkuar gjithmonë pranë njëri-tjetrit pa dallime fetare.

Dhe mbi të gjitha, historia jonë ka treguar se shqiptarët nuk kanë rënë asnjëherë pre e përpjekjeve jo të pakta për ta përçarë dhe krijuar konflikte midis komuniteteve tona fetare

Një ndihmesë konkrete për formimin e brezit të ri me cilësi pozitive edukuese, që promovojnë respekt, dashuri dhe harmoni midis njerëzve dhe besimeve fetare, përbën dhe karakteri laik i legjislacionit arsimor shqiptar, e në veçanti ai i arsimit të lartë, i cili përgatit specialistë të lartë pa motivuar preferenca individuale fetare. Misioni i arsimit të lartë realizohet duke studiuar, punuar dhe projektuar në bashkëpunim dhe me njëri-tjetrin, larg prirjeve penguese politike dhe fetare.

Realiteti i sotëm, tepër i ngarkuar me shqetësime jo të pakta, kërkon që të bëhen të gjitha përpjekjet, si nga institucionet zyrtare, ashtu dhe nga familja, shkolla dhe institucionet fetare, në mënyrë që të rinjtë tanë të mundësohen për të mësuar, për t'u edukuar dhe punuar në paqe dhe në harmoni.

Procesi i edukimit të individit është i gjatë dhe i vështirë dhe në këtë proces të gjatë, mbetet si një detyrë e trashëguar nga brezat e mëparshëm, apeli aktual për harmoni dhe bashkëjetesë fetare, si një moment shumë i rëndësishëm në përgatitjen dhe formimin e brezit të ri.

Harmonia dhe bashkëjetesa fetare duhet vlerësuar si një model i domosdoshëm edukimi, që duhet ruajtur dhe mbështetur nga të gjithë ne.

Dhimitër QOSJA

Akademia Teologjike

“Ngjallja e Krishtit”, Shënnavlash, Durrës

Kontributi i Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në ruajtjen dhe forcimin e harmonisë ndërfetare

Kisha Ortodokse në Shqipëri përbën komunitetin historik në këtë vend që ruan traditën e ardhur, *që nga shekulli i parë deri më sot, një komunitet me jetë, martirë të besimit, shenjtore të njohur dhe të panjohur, me ngjarje, histori dhe kulturë. Pas një periudhe intolerance dhe sprove të ashpër, për disa dekada, gjatë shekullit të kaluar, edhe pse struktura e Kishës u shpërbë, shpirti dhe ndërgjegjja ortodokse nuk pushoi së rrahuri në zemrat e shumë personave, që shpresonin në ringjalljen e saj.*

Me rënien e regjimit totalitar Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë filloi rrugëtimin e ringritjes, të misionit të saj spiritual, social dhe kulturor. Gjatë viteve të ringritjes së saj, krahas vështirësive të krijuara nga regjimi më i egër i shekullit, i është dashur të përballej edhe me ‘ligësinë e qarqeve të ndryshme nacionaliste dhe jo vetëm’, me reagimin e disave me pretekst origjinën e Primatit të saj. Këto deri diku mund të justifikohen për shkak të veshjes së tyre me dyshime dhe me një ksenofobi ndaj Kishës, ndaj klerit dhe jo vetëm, prej atyre që përjetuan ateizmin, të traumatizur prej tij dhe në pamundësi për të ndërtuar bunkerë pas viteve ‘90 kërkuan të vazhdojnë bunkerizimin e shpirttrave dhe mendjeve të njerëzve. Edhe pse sot jetojmë në një realitet tjetër, duket se ende ka një ngërc të pakapërcyeshëm të disave prej tyre. Megjithatë Kisha është e hapur, duke kultivuar durim dhe dinjitet, sepse natyra e saj është e tillë, të përballet me guxim dhe durim dhe të luftojë ndaj ligësisë, duke ofruar frymë dashurie, madje dhe ndaj armiqve (Mth. 5, 44).

Duke pasur parasysh zbrazëtinë e madhe të krijuar nga regjimi, rrënimin plotësisht të strukturës së Kishës, si dhe mjedisin multifetar, i kërkohej një vepër e gjithanshme në shumë fusha, për të zhvilluar rolin e rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm, bazuar në historinë e saj shekullore. Dhe një ndër këto fusha, që i ga-

ranton identitetin në këtë shtet me të cilën krenohemi të gjithë, është bashkekzistenca paqësore midis komuniteteve fetare.

Qëllimi, vizioni dhe lutja e Primatit të saj ka qenë realizimi i një Kisha të gjallë me një koherencë të qëndrueshme me një kontribut të gjerë në shoqëri si brenda, ashtu dhe jashtë vendit:

“detyrimi ynë është të ofrojmë thesaret shpirtërore të Orthodoxsisë, në liri, pa imponim. ...Kisha e Krishtit... çdo qelizë e saj, çdo anëtar i saj, ka për detyrë të ungjillizojë energjinë dhe prezencën e gjallë të Perëndi-njeriut në histori, të veprojë me fuqinë e Tij si faktor drejtësie, pajtimi, paqeje dhe shprese.”¹

Fortlumturia e tij Anastas, duke marrë parasysh karakteristikat e vendit dhe në respekt të këtij realiteti, në fjalën e tij me rastin e fronëzimit shprehu angazhimin e tij të palëkundur në mbështetje të traditës ndërjetare në Shqipëri dhe respektit reciprok:

“...Kisha Ortodokse ka qenë gjithnjë e do të jetë faktor bashkimi, paqeje dhe pajtimi në Shqipëri... Duke vazhduar traditën e vjetër të tolerancës fetare në Shqipëri, përkrah sinqerisht bashkëekzistencën paqësore dhe respektimin reciprok të komuniteteve të ndryshme fetare... kultivon ndjenja respekti dhe dashurie edhe për ata që akoma qëndrojnë indiferentë, apo edhe negativë ndaj fesë...”²

Ai me përvojën e madhe akumuluar, duke qenë anëtar në organizma dhe sektorë të ndryshëm si: “Dialog me njerëz me pikpamje të tjera fetare” (*Dialogue with Men of Other Faiths and Ideologies*) të Këshillit Botëror të Kishave (KBK-WCC) dhe të “Konferencës Botërore të Fesë për Paqen” (*World Conference on Religion and Peace*, KBFP-WCRP-ku Kryepeshkopi Anastas është president nderi)³, por edhe si një akademik në çështjet e Religjionit ka ofruar një kontribut të paçmuar në raportet ndërjetare, duke u shprehur se dialogu kontribuon në:

1. Nga ligjërata mbajtur në Konferencën Panevropiane në Athinë (4-6 maj 2003) me temë: “Parime dhe vlera për ndërtimin e Europës”, Delikostopoulou Athanasiou, Anastasios, Arkiepiskopos Tiranonkai Pasis Albanias, Epta-Lofos, Athinë 2005, fq. 265.

2. Shih “Ngjallja” nr.1, (1) Tetor 1992, fq. 5.

3. WCRP, u themelua në vitin 1970 dhe inkurajon bashkëpunimin midis religjioneve në botë. Në Asamblenë e 9-të Botërore, zhvilluar më 20-22 Nëntor në Vjenë, Austri, Kryepiskopi Anastas u rizgjodh President Nderi. “Ngjallja”, nr. 12 (252), Dhjetor 2013, fq. 1.

“...tejkalimin e keqkuptimeve, në forcimin e ndërgjegjes së arsyeshme fetare, në shkëmbimin e mendimeve dhe të kritikave, për të kuptuar shqetësimet, qëndrimet dhe argumentet e të tjerëve.”⁴

Nisur nga përvoja e tij, ai i dha një rëndësi futjes dhe integritit të plotë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë në këto organizma pa rezerva dhe pa frikë, duke e bërë anëtare me të drejta të plota në Konferencën Evropiane të Kishave (KEK-CEC) në 1992 dhe në 1994 në Këshillin Botëror të Kishave (KBK-WCC⁵). KOASH është komuniteti i vetëm Ekumenik në Shqipëri, që merr pjesë në Lëvizjen Ekumenike, duke kontribuar në raportet ekumenike, si në nivel lokal ashtu dhe në atë global. Anëtarësimi me të drejta të plota në këto dy organizma ishte i domosdoshëm, si nevojë e transformimit të shoqërisë njerëzore nëpërmjet një hapjeje ekumenike, për shkak të izolimit të gjatë totalitar.

Kështu Kisha në ecurinë e saj të ringritjes i dha një rëndësi të veçantë komunikimit dhe bashkëpunimit midis komuniteteve fetare. Ndërmori inisiativa të guximshme në pjesëmarrje dhe takime të ndryshme me një prezencë dinjitoze dhe dinamike, duke kontribuar në forcimin e marrëdhënieve dhe dialogut midis kishave dhe komuniteteve të ndryshme fetare.

Ajo ka zhvilluar marrëdhënie dypalëshe dhe shumëpalëshe ndërmjet komuniteteve të krishtera dhe ndërfaqetare, si kurrë më parë në historinë e saj. Midis tre komuniteteve të krishtera janë realizuar takime të përbashkëta për çështje të ndryshme, si edhe për të prezantuar një dëshmi të përbashkët të krishterëve, duke luajtur një rol parësor në themelimin e “Shoqërisë Biblike Ndërkonfesionale të Shqipërisë” për përkthime biblike⁶.

Ndërsa me Kishën Romano-Katolike në Shqipëri ekzistonte një traditë komunikimi, me komunitetin Ungjillor të shfaqur në mënyrë intensive pas fitimit të lirisë fetare në vend, komunikimi u bë më i lehtë, kur shumica e tyre vendosën të organizoheshin në një organizëm të përbashkët të njohur nga shteti nën emrin “Vël-lazëria Ungjillore e Shqipërisë”.

Pas njohjes zyrtare të tij, Kisha Ortodokse mori inisiativën për një takim dhe nën prezencën e një përfaqësie ndërmjet dy komuniteteve shprehu predispozicionin e mirë, duke theksuar nevojën e dialogut, të njohjes dhe bashkëpunimit. Nuk kanë

4. Anastasi, Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i gjithë Shqipërisë, Në Shqipëri Kryq dhe Ngjallje (Intervista), Botimet “Ngjallja” Tiranë 2017, fq. 284.

5. Asambleja IX e Përgjithshme në Porto Alegre të Brazilit 2006 zgjodhi me një zë Anastasin si njërin ndër tetë presidentët të saj, (në dhjetor të 2003, u zgjodh një ndër dy zëvendës-presidentët e CEC).

6. Anastasi, Kryepiskop i Tiranës..., Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë 1991-2012 (përshkrim i përmbledhur) Botimet “Ngjallja” Tiranë 2013, fq. 73.

munguar takimet dhe simpoziumet e ndryshme në kuadër të njohjes dhe bashkëpunimit të ndërsjelltë, për problematika dhe ngjarje, që kanë shqetësuar shoqërinë tonë, edukimin e saj me vlera të virtytit dhe moralit, për të frenuar sjellje devijuese, kriminale, korruptive etj⁷, si dhe për të kultivuar marrëdhënie mirëbesimi, bashkëpunimi dhe respektimi midis tyre.

Krahas takimeve të ndryshme ndërkristiane nuk mungojnë takimet ndërfaqetare, duke promovuar vlerën e bashkëjetesës në arenën ndërkombëtare dhe rolin e saj në imazhin e vendit. Primati i KOASH-së, ndër konferenca dhe takime të ndryshme ndërfaqetare, ka ofruar një kontribut të paçmuar, duke përcjellë mesazhe të paqes, bashkëjetesës dhe bashkëpunimit ndërmjet njerëzve dhe komuniteteve ndërfaqetare, referuar shembullit të Shqipërisë⁸. Të shumta janë pjesëmarrjet e saj ndër konferenca të ndryshme ndërfaqetare, veçanërisht pas ngjarjeve tragjike të vitit 2001, të cilat janë të pamundura t'i referojmë në këtë punim. Sidoqoftë, integrimi i saj në organizmat ndërkristiane, por edhe ndërfaqetare i ka dhënë një dëshmi esenciale nëpërmjet referimeve të ndryshme dhe veprimeve ndriçuese, duke vlerësuar si Kishën e Shqipërisë, ashtu edhe frymën e bashkëjetesës ndërfaqetare në Shqipëri.

7. Shih “Takim i përfaqësuesve të Vëllazërisë Ungjillore të Shqipërisë në Kryepiskopatën e Shënjtë”, “Ngjallja” nr. 11 (226) Nëntor 2011, fq. 3. Në 1994 komunitetet e krishtera u angazhuan në themelimin së bashku të Shoqërisë Biblike të Shqipërisë që u bë e mundur më 1996, “Ngjallja” nr. 7 (22) Korrik 1994, fq. 2, (kryetetarët drejtojnë sipas radhës këtë organizëm), “Ngjallja” nr. 11 (178) Nëntor 2007, fq. 5, shih. “U zhvillua simpoziumi i përkthimit - seancat u drejtuan nga Fortlumturia e Tij, Prof. Dr. Anastasi”, “Ngjallja” nr. 12, (75) Dhjetor 1998, fq. 11, Në kuadrin e bashkëpunimit midis komuniteteve të krishtera në Shqipëri është bërë e mundur përkthimi i Dhiatës së Re nga origjinali në gjuhën e sotme dhe vazhdon projekti i përbashkët për përkthimin e Dh. së Vjetër. Gjithashtu me inisiativës e Kishës Ortodokse në 18 janar 2007 u zhvillua një takim në qendrën “Thabor” në Tiranë “Ngjallja” nr. 2 (169) Shkurt 2007, fq. 6, Një takim i ngjashëm u zhvillua dhe në Shën Vlash më 10 Maj 2008, “Ngjallja” nr. 6 (185) Qershor 2008, fq. 3. Shih “Ngjallja” nr. 7 (282), Korrik 2016, fq. 2.

8. Gjatë viteve 90 merr pjesë në konferencën ndërkombëtare në Konstandinopojë, organizuar nga Patriarkana Ekumenike së bashku me Fondacionin Amerikan me qendër në Nju Jork “Appeal of conscience” me temë: “Paqja dhe Toleranca (Peace and Tolerance I), duke prezantuar Shqipërinë, por edhe duke kontribuar esencialisht në formulimin përfundimtar të deklaratës së përbashkët, e ashtëquajtura “*Deklarata e Bosforit*”, Shih Kronikë-Konferencë Ndërkombëtare për Paqen dhe Tolerancën “Ngjallja” nr. 3 (18) Mars 1994, fq. 1-3, kra. “Διεθνές Συνέδριο περί Ειρήνης και Ανεξίτηρησ κείας”, *Ορθοδοξία*, Περίοδος Β’, τομ. 1, τεύχ. Β’, Prill- Qershor 1994, fq. 331-347 (Revistë zyrtare tremujore e Patrarkanës Ekumenike) si dhe në Konferencën e zhvilluar nga 7 - 9 Nëntor 2005 (Peace and Tolerance II) shih “Dialog dhe mirëkuptim në Evropën Juglindore, Kaukaz dhe Azinë Qendrore-Stamboll: Konferenca e dytë për Paqen dhe Tolerancën” “Ngjallja” nr. 11 (154) Nëntor 2005, fq. 6. Në të njëjtin vit merr pjesë në takimet ndërfaqetare në Asizi-Itali, organizuar nga Kisha Romanokatolike nëpërmjet komunitetit të San Egidios, takime të cilat janë të përvitshme. Një ndër takimet me një theks të veçantë për Shqipëri ishte takimi ndërfaqetar në Tiranë në bashkëpunim me Kishën Ortodokse, në të cilën theksohej se: “Çdo dhunë në emër të fesë, dhunon esencën e fesë”, Shih “Ngjallja” nr. 9 (272), Shtator 2015, fq. 1, 3, 4.

Për këtë arsye, Kisha Ortodokse jo vetëm që respektoi traditën e mirëkuptimit, por me të drejtë nga sa dëshmojnë veprimtaritë e saj ka vulosur një periudhë të re në marrëdhëniet e bashkëjetesës, duke zhvilluar më tej respektin e ndërsjelltë të bashkëpunimit reciprok për një ecuri paqësore ndërmjet njerëzve.

Raportet multilaterale ndërfaqëse në Shqipëri dhe kontributi i Kishës Ortodokse në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve fetare

Shqipëria si një vend, i cili u gjend nën pushtetin otoman për pesë shekuj me radhë, ka fituar përvojën nga ajo periudhë dhe deri më sot, të bashkekzistencës ndërmjet Krishtërit dhe Islamit. Edhe pse historia i referohet pozivititetit të raporteve ndërfaqëse në Shqipëri⁹, pas viteve '90 u shfaqën disa zëra ekstremistë, të cilët janë trajtuar edhe në median e shkruar dhe vizive. Herë pas here është folur për rrezikun që mund t'i kanosej vendit tonë prej përplasjeve të brendshme dhe veçanërisht prej grupeve radikale¹⁰. Megjithatë ne kemi patur bindjen se zëra të tillë nuk përfaqësojnë komunitetin në historinë e bashkëjetesës sonë, traditë e moderuar dhe pajtuese, duke ruajtur vazhdimësinë e bashkekzistencës midis njerëzve me besime të ndryshme, lidhja e së cilës vjen prej rrethanave historike dhe shpirtërore. Këto lidhje u zgjeruan mëtej për në periudhën e sistemit komunist dhe si rrjedhim në shumë fshatra dhe qytete, por edhe në të njëjtin pallat jetojnë familje me besime të ndryshme. Me rënien e regjimit, që në fillim të ringritjes së tyre, të krishterë dhe myslimanë ishin të detyruar të përballonin probleme të përbashkëta. Filluan rimëkëmbjen e tyre brenda një mjedisi ateist. Raportet e ndërsjella dhe bashkëpunimi u dukën në mënyrë intensive dhe kjo u vërtetua në hapjen e institucioneve fetare të njëri-tjetrit, ku morën pjesë besimtarë të ndryshëm, pavarësisht nga përkatësia e komunitetit¹¹.

9. Clayer Nathalie, flet për ekzistencën e hapur dhe tolerant të komunitetit mysliman: “Rrënjët e Islamit në Ballkan”, gazeta “Shqip”, 18 Maj 2006, fq. 18-19.

10. Raste të trajtuara gjerësisht në median e shkruar dhe vizive, arrestime të grupeve të “xhihad-it” egjiptian me ndihmën CIA-s në 1998. Gjithashtu është folur për një kundravënie dhe antagonizëm midis brezit të vjetër dhe brezit të ri, që studiuuan jashtë vendit në shkollat e ndryshme dhe është pranuar edhe nga vetë krerët më të lartë të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë. Gazeta “Mapo” 18 Shtator 2010, fq. 2. Shala Xhavit, Ruajtja dhe promovimi i tolerancës fetare në Shqipëri është investim për të ardhmen tonë kombëtare, Simpoziumi- Domosdoshmëria e dialogut ndërfaqësor e ndërkulturore për Paqen Botërore. (Necessity of interfaith and intercultural dialogue for World Peace), Tiranë 2007, bot. Prizmi 2008, fq. 95 dhe 195, “Por harmonia dhe toleranca janë të rrezikuara nga ‘importi’ - But the religious harmony and dialogue is endangered from the ‘import’ Ai sjell referencë nga (National Report on Religious Freedom, 2005).

11. Në Nëntor 1990 në Shkodër hapen objektet e kultit në të cilën marrin pjesë të gjithë komunitetet fetare në këtë qytet, të pranishëm të krishterë dhe myslimanë së bashku. Shih Genti Kruja “Një qasje

Në historinë e ripërtëritjes së religjioneve është ruajtur tradita e çmuar e urimeve reciproke për festat midis komuniteteve dhe besimtarëve dhe janë zhvilluar takime dhe simpoziume të përbashkëta, konferenca ndërfaqetare etj, me qëllim kultivimin e një fryme bashkëjetese dhe bashkëpunimi si dhe promovimin e këtyre vlerave, brenda dhe jashtë Shqipërisë¹².

Për t'u shënuar është mbajtja e “Forumit për Dialogun Ndërfetar në Europën Juglindore” më 16 janar 2009, i cili miratoi edhe “Deklaratën e Tiranës”, ku parashtoi “rritja e bashkëpunimit ndërfaqetare, ndërrelikjionik dhe ndërkulturor në rajon.”¹³ Takimet ndërfaqetare gjithmonë janë parë si një mundësi për të ripërtërirë angazhimin e të gjithëve, për forcimin më tej të bashkëpunimit dhe bashkekzistencës dhe për të përcjellë këtë frymë tek brezat më të rinj¹⁴.

Në një moment të caktuar, në mars të vitit 2005, të katër liderët fetarë të komuniteteve fetare tradicionale, në kuadrin e bashkëjetesës dhe harmonisë ndërfaqetare, firmosën një deklaratë të përbashkët.¹⁵ Kujtojmë se kësaj ngjarjeje i kishte paraprirë takimi i tretë i 7-10 nëntorit të vitit 2004 i Këshillit të Liderëve Fetarë në Evropë, në Leuven të Belgjikës, në të cilin Primati i Kishës Ortodokse shprehu idenë e krijimit të një Këshilli Ndërfetar në Shqipëri, për të nxjerrë në pah: “marrëdhëniet shumë të mira ndërfaqetare në Shqipëri” për promovimin e tyre si një shembull të shkëlqyer për vende të tjera të Ballkanit¹⁶.

praktike për bashkëjetesën fetare në Shqipëri, lidhja e modelit Gylen me atë shqiptar” (128-140) fq. 137, Simpozium Ndërkombëtar “Këndvështrim i Diversitetit Fetar, Kulturor dhe Shoqëror në Ballkan nga Perspektiva Globale”, 25-26 Mars 2011, Tiranë, Prizmi 2012; Në pritjen e Anastasit më 16 Korrik ishin të pranishëm dhe përfaqësues të komuniteteve fetare, Shih Dhima Aleko, Dëshmi të një besimtari të përunjur – Kujtime nga jeta ime në shërbim të Kishës, bot. Orthodox Research Institute, Boston 2010, fq. 112,

12. Shih “Ngjallja” nr. 12, (75) dhjetor 1998, fq. 1,2,8. “Asambleja e 7-të e Konferencës Botërore për Fenë dhe Paqen, Aman-Jordani”, në të cilën në një ndër seancat plenare Kryepeshkopi Anastas ishte në rolin e moderatorit, shih “Ngjallja” nr. 12 (87), Dhjetor 1999, fq. 12. Konferenca Budapestit, shih “Ngjallja”, nr. 6 (93), Qershor 2000, fq. 1. Veçojmë ndihmën konkrete për mbarëvajtjen e veprimtarisë së “Islami në Europë” sektor i KEK (CEC) të zhvilluar në Shqipëri në shtator 2000 me qëllim organizimin e Konferencës Ndërfetare të Sarajevës, shih “Ngjallja” nr. 9 (96) Shtator 2000, fq. 1-2. “Tiranë–Konferencë ndërkombëtare për besimet...”, “Ngjallja”, nr. 3 (102), Mars 2001, fq. 12. (South East Europe Interfaith Conference) në 16-19 Nëntor 2005. “Ngjallja” nr.12 (155), Dhjetor 2005, fq. 1, 3. Takimi i organizuar nga “NATO Science for Peace Project” nga 19 Shtator–1 Tetor 2006, “Ngjallja” nr. 10 (165) tetor 2006, fq.12.

13. Shih “Ngjallja”, nr.2 (193), shkurt 2009, fq. 2.

14. Nga simpoziumi i përbashkët në nëntor të vitit 2010 me temë: “Kontributi i Harmonisë Ndërfetare në Integrimin Europian të Shqipërisë”, Ssih “Ngjallja” nr. 11 (214), Nëntor 2010, fq. 1, 2.

15. Gazeta “Shekulli”, 19 Mars 2005, gjithashtu, “Ngjallja” nr. 4 (147), Prill 2005, fq. 2, 3.

16. Ky organizëm është pjesë e “Këshillit Botëror të Fesë për Paqen” (WCRP), Shih “Ngjallja” nr.12 (143) dhjetor 2004, fq. 6.

Kështu në shkurt të vitit 2007, u krijua “Këshilli Ndërfetar i Shqipërisë” (Inter-Religious Council of Albania)¹⁷ në krijimin e të cilit Kontributi Ortodoks ishte përcaktues.¹⁸ Një garanci për frymën e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve fetare përbëjnë edhe takimet apo simpoziumet e përbashkëta ndërmjet institucioneve arsimore përkatëse, shkollave teologjike në vend. Fillimisht takimet e bashkëpunimit dhe dialogut nisën ndërmjet Akademisë Teologjike dhe Seminarit Ndërdioqezan të Kishës Romano-Katolike (viti 2000) dhe më vonë me krijimin e Kolegjit Universitar “Bedër” (2011). Së bashku kanë zhvilluar takime me tema të ndryshme¹⁹, si dhe shkëmbim të pedagogëve përkatës ndërmjet shkollave për të prezantuar tek tjetri, komunitetin, që përfaqësojnë në mënyrë më objektive. Në të njëjtën frymë për të njohur më tepër për bashkëjetesën ndërfetare, në Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit” në Durrës zhvillohet lënda mbi Religjionet në përgjithësi dhe mbi Islamit në veçanti.

Krahas komunikimit dhe takimeve në nivele të ndryshme, një rol të rëndësishëm në frymën e paqes dhe bashkëjetesës e luajnë veprimtaritë humanitare, shëndetsore dhe arsimore etj, me ngritjen e dy fondacioneve të Kishës Ortodokse²⁰, duke sjellë një kontribut në mirëkuptimin dhe paqen sociale, pa bërë dallime, veçanërisht në kohë krizash²¹. Me nisjen e valës së të shpërngulurve nga Kosova ofroi gjithçka të mundshme, duke përjetuar dramën e këtyre njerëzve²². Me të njëjtën frymë

17. Shih, “Ngjallja”, nr. 3 (170) Mars 2007, fq. 4, Ceremonia e inaugurimit të Këshillit Ndërfetar të Shqipërisë u bë në Tetor 2009, “Ngjallja”nr.10, (201) tetor 2009, fq. 1.

18 Anastasi, Kryepiskop i Tiranës..., *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale...*, fq. 74.

19. Shih Ngjallja” nr.1 (276), Janar 2016, fq. 4. “Ngjallja” nr. 5 (280), Maj 2016, fq.3, “Ngjallja” nr. 1 (288), janar 2017, fq. 4. “Veprimtari midis institucioneve akademike fetare” Ngjallja” nr. 5 (292), maj 2017, fq. 5, “Dashuria Hyjnore”- Takim Ndërfetar në Akademinë Teologjike “Ngjallja e Krishtit”, Ngjallja”, nr. 12 (299), dhjetor 2017, fq. 2.

20. Fondacionet “Klinika Orthodhokse e Ungjillëzimit” për shërbimet shëndetësore dhe “Fryma e Dashurisë” në fushën e arsimit, shih Anastasi, Kryepiskop i Tiranës..., *Ringritja e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë 1991-2012*, fq. 51.

21. Anastasi, Kryepiskop i Tiranës..., *Ringritja e Kishës Orthodhokse...*,fq. 77, ofron ndihmë në rikonstruksionin e Universitetit Bujqësor të Kamzës, “Ngjallja”, nr. 11 (62), Nëntor 1997, fq. 1, të shkollës së Ndroqit, “Ngjallja” nr. 2, (89), shkurt 2000, fq. 1, të Luzit të Vogël-Kavajë, “Ngjallja”, nr. 9 (96) shtator 2000, fq. 12. Anastasi, Kryepiskop i Tiranës..., *Ringritja e Kishës Orthodhokse...*, fq. 59. Në fushën e arsimit kopshtet dhe shkollat e ndryshme, krahas dijeve funksionojnë edhe si një fidanishte të kultivimit të bashkëjetesës fetare.

22. Që në vitin 1998 u bënë thirrje për krizën në Kosovë-13. 03. 1998 si dhe ndër kisha për të ndihmuar vëllezërit nga Kosova. Shih “Ngjallja” nr. 6 (69), qershor 1998, fq. 1. “Pranë shqiptarëve të ardhur nga Kosova”, shih “Ngjallja” nr. 2 (77), Shkurt 1999, fq.1, “Ngjallja” nr. 4 (79), prill 1999, fq. 1-2, “Ngjallja” nr. 5 (80), maj 1999, fq. 3. “Kisha po rron brenda tragjedisë së Kosovës”, intervistë e Kryepeshkopit Anastas botuar në gazetën “Zëri i Popullit” 07 maj 1999, si dhe “Ngjallja” nr. 5 (80), maj 1999, fq. 7-8. Kujtojmë Kampin për të shpërngulurit nga Kosova “Ngjallja” nr. 5 (80),

shprehu angazhim për paqen ndaj ngjarjeve të Kosovës të vitit 2004, si një ndër komunitetet që reagoi konkretisht në mënyrë ndërtuese, duke dhënë një mesazh të fuqishëm për mospërdorimin e fesë për të ndezur konflikte:

“...*Feja* është dhuratë hyjnore për të zbutur zemrat, për të shëruar plagët dhe për t’i sjellë paqësisht njerëzit më afër me njëri tjetrin”,- vaj për të shëruar *plagët dhe jo vaj për të ndezur zjarrin.*”

një shprehje, e cila është bërë leitmotiv.²³

Që nga tetori i vitit 1998, kishte ofruar strehim me kampet e ngritura posaçërisht për qytetarët e Kosovës me kushtet optimale të jetesës për 33.000 refugjatë. Ky moment shënoi fillimin e një miqësie dhe nga viti 2001 nisi organizimi i kampeve me natyrë edukative dhe argëtuese në shkolla të ndryshme të Malishevës në bashkëpunim me mësuesit e tyre. Numri arriti shifrën në 1.800 nxënës (2008 dhe 2009), fakt që tregon frymën e paqes, dashurisë dhe solidaritetit të ofruara pa interes prozelitizim e një fryme miqësie, paqeje dhe dashurie²⁴. Në të njëjtën frymë ofroi kontribut të paçmuar në takimin në kuadrin e KBK, një kontribut i qenësishëm në dialogun midis komuniteteve fetare të Shkupit, zhvilluar në Morzh (Morges) të Zvicrës²⁵, që me shembullin e saj u vlerësua roli i Kishës Ortodokse dhe i primatit të saj, i cili theksoi se: “paqja është shumë e rëndësishme që ta lëmë vetëm në duart e politikanëve.”²⁶

Përmbyllje

Kisha Ortodokse me autoritetin spiritual që e karakterizon kontribuon në koherencën shpirtërore morale dhe shoqërore të njerëzve në tërësi. Në një mjedis multifetar për ekzistencën e harmonisë dhe bashkëpunimit midis komuniteteve dhe për parandalimin e fanatizmit, apo konflikteve të mundshme, dialogu ndërfaqësor (interfaith dialogue) konsiderohet një domosdoshmëri. Krahas dashamirësisë, ftohemi

Maj 1999, fq. 1, 12. Madje Kampi i fundit që funksionoi për ta ishte ai i cili administrohej nga Kisha Ortodokse, shih “Ngjallja” nr. 7 (94), korrik 2000, fq. 1, 3 dhe “Ngjallja” nr. 6 (105), qershor 2001, fq. 1, 2.

23. Anastas (Janullatos), Gjurmë nga kërkimi i transhendentës..., Bot. “Ngjallja” Tiranë 2010, fq. 325, Shih “Ngjallja” nr. 4 (135), prill 2004, fq. 1, 6.

24. Në respekt të miqësisë së ndërtuar në vitin 1999, filluam kampet ditore. Në këto kampe u zhvilluan aktivitete, për të ofruar shpresë përballë traumave të fëmijëve për shkak të luftës, shih “Ngjallja” 2002 (tetor), 2008 (Shtator), 2009 (Gusht), (Shtator 2013), Shih: “Koha Ditore”, “Kampet model shkollash verore-vullnetarë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë organizojnë kampe për fëmijë të Malishevës” (9 korrik 2007).

25. Shih “Fortlumturia e Tij Anastasi kryeson tryezën e rrumbullakët me përfaqësues komunitetesh fetare të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, takimi i zhvilluar më 11-13 qershor 2001, “Ngjallja” nr. 7(106) korrik 2001, fq. 5.

26. Anastas (Janullatos), Gjurmë nga kërkimi i transhendentës..., fq. 320.

të ruajmë mospërgjithësimin e pikëpamjeve, për të mos krijuar iluzione që mbartin rreziqe. Nga ana tjetër ruajtja e traditës përbën kushtin e bashkekzistencës paqësore në Shqipëri. Pjesëmarrja në takimet e ndërsjella përbëjnë rrjedhojë të besimit tonë, sepse:

1. Pavarësisht bindjeve të ndryshme njeriu nuk pushon së qeni krijesë e Perëndisë “sipas ikonës së Tij” (Zan. 1, 26), me natyrë të përbashkët, “prej një gjaku” (Vep. Ap. 17, 26). Kjo përbën bazën, që ai nuk është i privuar përballë mesazheve prej së larti. Ky angazhim sjell përmbushjen e qëllimit të njeriut me bindjen se Ai është “Ati i të gjithëve” (Efes. 4, 6) dhe se në këtë të vërtetë ekziston misteri i shoqërisë së dashurisë dhe bashkëjetesës²⁷.

2. Çështje e thelbit të ekzistencës dhe identitetit të Kishës, sepse nisja e ekzistencës së saj qëndron mbi faktin se “Fjala u bë mish” (Jon. 1, 14), që shpreh parimin themelor të bashkimit të shoqërisë mbarënjerezore, i cili kapërcen kufijtë racorë, gjuhësorë, nacionalë, gjinorë, etj.

3. Përvoja, bazuar në veprën e J. Krishtit, i cili bisedoi me njerëz me tradita të ndryshme fetare (Mat. 8, 10, Lluk. 7, 9, Jon. kap. 4. etj)²⁸.

Si rrjedhim Kisha Ortodokse është e vendosur për të kultivuar marrëdhënie më të thella bashkëpunimi dhe dialogu, madje edhe për çështje kritike të kohës sonë²⁹, për qëndrueshmëri në një bashkekzistencë paqësore midis atyre që besojnë, por edhe atyre që janë në kërkim, duke synuar edhe kapërcimin e paragjytimeve dhe dyshimeve. Nga gjithë aktiviteti i saj në lidhje me marrëdhëniet ndërfitare, ajo që e karakterizon kishën Ortodokse në raportet ndërfitare është bindja e palëkundur ndaj “shërbimit të pajtimit” (Letra II Kornt. 5, 18). Këtë jo thjeshtë mbi një kopje të së shkuarës, por mbi perspektivën e situatave të reja politiko-shoqërore në nivel lokal dhe global³⁰. Kontributi i saj, përbën një burim shprese dhe morali jo vetëm për ortodoksët, por për shoqërinë në përgjithësi, duke ofruar në sektorë të ndryshëm të kulturës, ekonomisë, ambientit etj. Veprimtaria e saj sociale dhe humanitare ndaj gjithë njerëzve me dashuri dhe pa kurrfarë dallimi, pas rimëkëmbjes deri më sot është rrjedhojë e ripërtëritjes shpirtërore, frymëzuar nga Ungjilli dhe kontribuon për krijimin e një shoqërie dashurie, solidariteti dhe ofrimi për një bashkekzistencë paqësore midis njerëzve dhe komuniteteve, duke e konsideruar si një sfidë dhe një mundësi³¹.

27. Anastasi, Kryepiskop i Tiranës...Globalizmi dhe Orthodhoksia, “Ngjallja”, Tiranë 2004, fq. 37.

28. Anastas (Janullatos), Gjurmë nga kërkimi i transhendentës..., “Ngjallja”, Tiranë 2010, fq. 344.

29. Shih Anastasi, Kryepiskop i Tiranës...Globalizmi dhe Orthodhoksia, fq. 167, në të cilin rendit: shekullarizimin, depersonifikimin e shoqërisë, shkatërrimin e mjedisit, të drejtat njerëzore, drejtësinë dhe paqen botërore.

30. Anastasios, Arcivescovo di Tirana, di Durazzo..., Vivere insieme, Il contributo delle religioni a un'etica della convivenza, 2017 Edizioni Qiqajon-Comunità di Bose, fq. 71.


31. “Tradita dhe vizioni i bashkekzistencës paqësore të komuniteteve fetare në Shqipëri” fq.5-19,

Përveç takimeve të ndryshme, ajo nëpërmjet institucioneve të ndryshme arsimore (kopshteve-20 të tillë), shkollave të saj (Tiranë 2002, Durrës 2004, Gjirokastrë 2008) dhe Kolegjit Universitar “Logos” në Tiranë, në të cilat marrin pjesë shumë prej të cilëve nuk u përkasin familjeve ortodokse, ofron jo vetëm një formim arsimor, por edhe një frymë solidariteti dhe koherence sociale, si dhe frymën e dashurisë së paimterestë. Të gjitha këto në ndihmë të forcimit strukturor të bashkekzistencës midis njerëzve “për ngritjen e nivelit të jetës, të mendimit, të arsimit të shëndetit dhe të kulturës”³². Në këta sektorë ka përqafuar njeriun, pavarësisht bindjeve, apo preardhjes, apo kujt feje i takon apo nëse beson ose jo, mbështetur tek shembulli që ofroi Krishti, ai i “Samaritanit të mirë” (Lluk. 10, 25-37). Në qendrat rinore ofrohen vlera diakronike, një formim shpirtëror ku mund të veçojmë kampet verore, ku marrin pjesë pothuajse 1.000 fëmijë çdo vit (filluan në 1995). Kampet janë kthyer në qendra formimi, duke mësuar të kultivojnë respektin dhe veçoritë e secilit, miqësinë dhe dashurinë solidare.

Për veprën e saj dhe kontributin e Primatit, që ka udhëhequr KOASH-in, është vlerësuar me çmime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit me çmimin “*Pro Humanitate*” nga fondacioni “Pro Europa” për vitin 2001³³ dhe çmimin ndërkombëtar nga Universiteti Pontifikal i Napolit, Itali, duke theksuar kontributin në “ripërtëritjen e biomës fetare në Shqipëri për krijimin e klimës së tolerancës dhe frymës së bashkëjetesës paqësore dhe vëllazërore midis komuniteteve fetare në Shqipëri”³⁴.

Gjithashtu me urdhërin “Gjergj Kastrioti-Skënderbeu” nga ish-presidenti i Republikës B. Topi, me motivacionin:

këtu Revista “Kërkim”Nr. 13, Botimet “Ngjallja” Tiranë 2015, “Problems and Prospects of Interreligious Dialogue”, fq. 1-8,



Prill 2010

Në fjalën e falënderimit Kryepiskopi Anastas theksoi:

"Të gjithë ne, komunitetet fetare tradicionale, përpiqemi jo thjesht të mbështesim tolerancën, por të mbështesim mirëkuptimin dhe bashkëpunimin vëllazëror midis nesh. Ju duhet ta dini z. President, që në kohët e vështira që ka kaluar vendi, në kohëra krizash ne kemi theksuar se vaji i fesë nuk duhet për të ndezur më shumë flakën e konflikteve, por të jetë gjithnjë për të shëruar plagët dhe për të ndihmuar paqen.

Ne përpiqemi të krijojmë në Shqipëri një shembull, që mund të eksportohet këtu në Ballkan, që përballohet me shumë vështirësi, por dhe që të jetë një mesazh për gjithë botën. Ne po punojmë për shek. XXI, për një botë të mirëkuptimit, të paqes dhe të dashurisë."

Emanuel LUSHA

Akademia Teologjike

“Ngjallja e Krishtit”, Shën Vlash, Durrës

Kushtet historike që ndikuan në ruajtjen e harmonisë fetare në Shqipëri

Bashkëjetesa paqësore e komuniteteve fetare në përgjithësi mund të vijë nga pikënisje të ndryshme. Si nga indiferenca për përvojën fetare, ashtu edhe nga përjetimi i ndërjegjshëm, i esencës më të thellë të fesë, siç ajo shfaqet qartë në jetën e shumë personaliteteve të spikatura të të gjitha besimeve. Përkundrazi, urrejtja e verbër fetare dhe armiqësia midis komuniteteve fetare, që bashkekzistojnë me njëri-tjetrin mund të lindin si nga farat e tipit të jashtëm fetar, një fanatizëm fetar ekstrem, ashtu edhe nga rrënjë jofetare për shembull faktorë politikë, nacionalistë, apo edhe shkaqe psikologjike vetjake, që kërkojnë të përdorin fenë për synime të tjera. Të gjitha këto rrënjë kanë ekzistuar të forta në të shkuarën dhe janë prezent edhe sot në Shqipëri.¹

Kemi disa faza karakteristike historike të historisë së fesë në Shqipëri që do të analizojmë, sepse e shkuara nuk u përket arkivave, por është themeli i së sotmes.

Fazat karakteristiko-historike

Historianë dhe politikanë shqiptarë theksojnë me kënaqësi të madhe se Shqipëria, megjithëse me 3 fe të ndryshme, nuk njohu luftra fetare gjatë historisë.² Presidenti i Republikës Bamir Topi në datën 5 prill 2010 dekoroi 4 udhëheqësit më të lartë të komuniteteve fetare tradicionale: Kryetarin e Komunitetit Mysliman Haxhi Selim Muçën, Kryepiskopin e Tiranës, Durrësit dhe gjithë Shqipërisë, Fortlunturinë e tij Anastasin, Kryegjyshin Botëror të Bektashinjve Haxhi Dede Reshat Bardhin dhe Arqipeshkv Metropolit të Tiranës, Durrësit dhe Kryetar i Konferencës Ipeshkvnore Katolike Imzot Rrok Mirditën me urdhërin e lartë “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”. Motivacioni i shkruar në dekorimin e Kryepiskopit ishte “...për forcimin dhe pasurimin e mëtejshëm të harmonisë, tolerancës dhe bashkëjetesës ndërfitare të popullit shqiptar”³.

1. Kryepiskopi Anastas, revista Kërkim nr 13, Tiranë 2015 fq. 4, 5.

2. Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Historia e Popullit Shqiptar, Tiranë 2002, Vëllimi I, fq. 607.

3. Gazeta Ngjallja, prill 2010 fq. 1-2, Nr. dekretit 6487, Tiranë 01.04.2010.

Presidenti i Republikës theksoi në ceremoninë e dekorimit:

“Është nder dhe privilegj për mua të tregoj dhe të lartësoj një vlerë të veçantë të popullit dhe vendit tim: Bashkëjetesën mes feve historikisht tradicionale përfshirë edhe disa grupe me të vogla.... kjo bashkëjetesë e kultivuar në dekada e shekuj ka në themel vlerën e besimit që i bashkon njerëzit pavarësisht sesi ia drejtojnë ata lutjet e tyre Zotit të përbashkët. Kjo bashkëjetesë është atribut i bashkësive fetare përfaqësuese, që predikojnë me urtësi dhe përkushtim besimin e tyre.”⁴

Prania e luftrave fetare nënkupton ekzistencën e komuniteteve të ndryshme fetare dhe mundësinë e konflikteve fetare.

Periudha e parë

Periudha e parë nis nga lindja e Krishtërit deri në pushtimin otoman. Në hapësirën e trojeve iliro-shqiptare nuk ka patur kushte të tilla për konflikte fetare gjatë mijëvjeçarit të parë. Me ardhjen në pushtet të Konstandinit të Madh, si perandor i Romës filloi dhe liria fetare për të krishterët e Perandorisë, që nisi me ediktin e Milanos në vitin 313⁵ dhe kristianizimin e Perandorisë Romake. Perandori Teodos i Madh në vitin 395 ndau Perandorinë Romake në 2 pjesë: Lindje e Perëndim⁶. Trevat iliro-shqiptare hynë në përbërje të Perandorisë Bizantine, siç quhet zakonisht pas kësaj date Perandoria Romake e Lindjes, që për nder të Konstandinit të Madh e quajti kryeqytetin e vet Konstandinopojë⁷. Në këtë mënyrë, midis Lindjes dhe Perëndimit u vendos një kufi, që me kalimin e kohës do të skalitet në mënyrë të prerë si kufiri midis botës kulturore Perëndimore Romake dhe botës Kulturore Bizantine.⁸

Ky kufi do të forcohet më shumë me ndarjen e kishave në vitin 1054. Deri në epokën e skizmës së madhe të krishtërit në vitin 1054, uniteti fetar i shqiptarëve ishte diçka që vinte në mënyrë të natyrshme. Nga pikëpamja e organizimit të përgjithshëm kishtar, Kisha në trojet iliro-shqiptare ishte nën autoritetin e Papës së Romës. Këtë autoritet e ushtronte nëpërmjet vikariatit romak të Selanikut,⁹ por nga

4. Po aty.

5. Revista Kërkim nr 11 Tiranë 2013 fq. 50-51.

6. Gjon Berisha Arbërorët ndërmjet Kishës Perëndimore dhe asaj Lindore gjatë shekujve XI-XV Prishtinë, 2015, fq. 38.

7. Shih Historia e Popullit Shqipëtar fq. 199.

8. Shih Gjon Berisha Arbërorët..., fq. 38-39.

9. Po aty, fq. 40-41.

shekujt V dhe VI Patriarkana e K/pojës u përpoq të vërë nën autoritetin e saj peshkopët shqiptarë. Perandori bizantin Anastas me origjinë nga Durrësi (484-519) ndikoi për të forcuar lidhjet e mitropolisë së Durrësit me Patriarkanën e K/pojës, kurse perandori tjetër ilir Justiniani (527-/5) rikonfirmoi lidhjet e peshkopatave shqiptare me Papën e Romës.

Ngjarja më e madhe në kuadrin e organizimit kishtar të trevave shqiptare ishin vendimet e vitit (732-733)¹⁰ të Perandorit bizantin ikonoklast Leoni III për t'i hequr peshkopatat shqiptarë nga varësia e Papës së Romës dhe për t'i kaluar në juridiksionin e Patriarkanës së K/pojës¹¹.

Kisha e Romës u përpoq vazhdimisht të rifitojë të drejtat që ka patur mbi kishat e Ilirisë, por pa sukses. Patriarku Foti I i Madh (855-867); (877- 886), i cili duke iu përgjigjur Papës, i thekson se ishte zakoni i vjetër që të drejtat kishtarë dhe sidomos ato të enorive të ndryshoheshin pas atyre politiko-administrative¹². Meqenëse pra, krahinat ilire ishin të bashkuara politikisht me K/pojën, lipsej që edhe kishtarisht të vareshin që andej. Sinodi i Madh Kishtar, që u mbledh në kohë të Fotit (879-880) ia njohu njëherë e përgjithmonë të drejtën e kishës së K/pojës mbi kishat e Ilirisë, të cilat me vonë, në vitin 884, u regjistruan dhe në Kodikun e Bazilikatave.¹³

Fuqizimi i Patriarkanës Ekumenike, që shkonte paralelisht me fuqizimin e Perandorisë Bizantine, solli edhe fuqizimin e pozitave të mitropolisë ortodokse të Durrësit në kuadrin e dioqezave arbëroro-shqiptare. Kështu në Notian e Leonit VI (886-912) Mitropolia e Durrësit kishte në juridiksionin e saj edhe peshkopatat e Krujës, Lezhës, Dioklesë, Shkodrës, Drishtit, Pultit, Tivarit etj.¹⁴ Në Notian e Jani Cimishit (969-976) Mitropolia e Durrësit kishte 14 seli peshkopale vartëse, nga Vlora në Tivar, pra tërë trojet arbërore në veri. Kjo tregon shtrirjen e kishës ortodokse nën autoritetin e Patriarkanës Ekumenike të K/Pojës. Me Perandorinë Bizantine dhe Patriarkanën Ekumenike shqiptarët e krishterë kanë hyrë në orbitën e krishtëritimit lindor (ortodoks). Deri në shek. X-XI arbërorët ndanin të njëjtin besim me bizantinët¹⁵. Këtë e thotë edhe historiani bizantin Ataliati në shek. XI, por në fillim të krizës së Perandorisë Bizantine, në shek. XI, dioqezat kishtarë veri-perëndimore filluan të lidhen me kishën e Romës. Këtë proces e nisën princat feudalë vendas të Dioklesë me qëllim krijimin e një formacioni politik shtetëror dhe fetar të pavarur nga Perandoria Bizantine¹⁶.

10. Shih Historia e Popullit Shqiptar, fq. 202-203.

11. Po aty, fq. 202.

12. Dhimitër Beduli Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944 Tiranë 1992, fq. 8-9.

13. Po aty, fq. 8-9.

14. Shih Gjon Berisha, Arbërorët..., fq. 66.

15. Shih Gjon Berisha..., fq. 78, 95, 96 dhe shih Historia e Popullit Shqiptar fq. 245.

16. Po aty, fq. 80

Princat e Dioklesë i shfrytëzuan dhe inkurajuan përpjekjet e klerit të tyre për shkëputje nga Patriarkana Ekumenike. Rezultat i përpjekjeve të tyre ishte shkëputja në vitin 1022 e peshkopatave të Ulqinit dhe Tivarit nga Mitropolia e Durrësit dhe bashkimi me kishën e Romës. Roma i vendosi nën juridiksionin e Mitropolisë Katolike të Raguzës (Dubrovniku i sotëm). Shembullin e peshkopatave të Ulqinit e Tivarit e ndoqën më vonë edhe peshkopatat e tjera shqiptare të Veriut. Me krizën e Perandorisë Bizantine u rrit presioni i Kishës Romane. Në shek. X Kisha Ortodokse në Shqipëri është në pozicion mbrojtës dhe duhet të luftonte kundër dinamizmit latin në Veri. Kisha Romane në ofensivë e sipër në shek. XII ishte e vendosur të eliminojë nga rajoni shqiptar çdo gjurmë ortodokse. Papatit i është dashur mund i madh dhe shkathësi politike, që përmes urdhërave benediktime, më vonë domenikanëve dhe franceskanëve nga njëra anë dhe e pushtuesve normano-anzhuinë, venedikasve nga ana tjetër, të jetë e pranishme në këto treva.¹⁷

Pas pushtimit të K/pojës nga kryqëzata IV në vitin 1204 tokat bizantine (edhe Shqipëria) iu nënshtruan një procesi ndryshimi politiko-social dhe ekonomiko-fetar. Pati ndryshime në strukturën kishtarë. Kisha Katolike ishte përpjekur 300 vjet me radhë për të zotëruar kishtarisht Durrësin me çdo mjet, mënyra, por pa sukses. Kisha Katolike u përpoq që në të gjitha territoret ortodokse të pushtuara nga krqtarët katolikë t'i kthente peshkopatat ortodokse në Peshkopata Katolike, por pa ndihmën e ndonjë pushteti politik kjo përpjekje nuk kishte patur sukses. Në vitin 1204 venedikasit morën kontrollin e kishës, pas pushtimit të K/pojës¹⁸, dhe vendosën një patrik latin. Venedikasit pushtuan Durrësin dhe krijuan dukatin venedikas të Durrësit. Patriku Latin u mundua të vendoste në Durrës një peshkop latin, sepse kryepiskopi ortodoks i qytetit nuk iu nënshtrua.

Në vitin 1208, pas 5 shekujsh, Durrësi ishte pajisur me një kryedhjakon katolik, që u zgjodh nga kisha latine e Durrësit, sepse ortodoksët nuk iu nënshtruan riteve katolike. Në gjysmën e dytë të shek. XIII, kur Karli Anzhuin I grumbulloi territoret e pushtuara në Shqipëri nën një formacion politik më vete të quajtur "Mbretëria e Arbërisë", me kufij më të gjerë se principata e Arbërit, ai i detyroi dioqezat kishtarë të territoreve të pushtuara të kalonin në ritin romano-katolik.¹⁹ Ndarja zyrtare e Kishës në vitin 1054, në Kishën Ortodokse të Lindjes me qendër Konstandinopojën dhe atë Romano-Katolike me qendër Romën, i gjeti trojet shqiptare të ndara midis dy qendrave të mëdha të botës së krishterë. Pjesa më e madhe e tyre vazhdon të qëndrojë e bashkuar me Patriarkanën Ekumenike të K/pojës (Stambollit). Kisha Romane Katolike ishte përqendruar në skajin Veri-Perëndimor të Shqipërisë.²⁰ Ndarja në dy rite: Ortodokse Bizantine dhe Romane Katolike nuk

17. Po aty, fq. 99; shih Historia e Popullit Shqiptar ...fq. 231.

18. Po aty, fq. 103-105.

19. Po aty, fq. 81.

20. Shih Histori e Popullit Shqiptar, fq. 245.

u shoqërua me krijimin e ndonjë komuniteti të veçantë politik-fetar, që t'i kundërvihet komunitetit tjetër të veçantë politiko-fetar²¹. Në këtë periudhë, që zgjati nga vitet apostolike shek. I, deri në fund të shek. XV (ardhja e otomanëve) shqiptarët nuk kishin konflikte të brendshme ose kundërvënie, edhe pse influencat ishin të forta si nga Lindja edhe nga Perëndimi.²²

Ndarja fetare apo mungesa e një përbashkësie fetare tek shqiptarët duhet të ketë krijuar vështirësi të tjera në zhvillimin e tyre të njësuar historik, kulturor.²³

Periudha e dytë

Në periudhën e dytë, nën pushtimin otoman, në vitet 1453-1912, u vu re një ulje e vazhdueshme e komuniteteve të krishtera në dobi të atij mysliman. Islamizimet kulmuan në shek. XVI-XVII. Kështu, paralelisht me të dy kishat e krishtera, u krijuan edhe komunitetet myslimane sunni dhe bektashi, si dhe disa tarikate të tjera islame.

Midis shqiptarëve u vu re një rrjedhje më e madhe drejt Islamit, ndryshe nga sa është vënë re në etnitë e tjera të Ballkanit. Ka shumë arsye.

a- Arsye të përgjithshme që qenë përcaktuese në lidhje me islamizimin e të krishterëve të etnive të ndryshme.²⁴

b- Faktorët lokalë. Përhapja e Islamit në tokat shqiptare ishte një dukuri e shkaktuar prej bashkëveprimit të faktorëve të natyrave të ndryshme: politik, ekonomik, kulturor dhe fetar. Për shkak të pozitës gjeopolitike delikate, si dhe prirjeve luftarake të spikatura të banorëve të saj, Shqipëria u bë jo vetëm një nga vendet 'devshirmeja' gjeti zbatimin më të gjerë, por edhe vendi, që përgjithësisht u qeveris nga shqiptarë të dalë nga kontigjentet e 'devshirmes' ose të edukuar në oborrin e sulltanit me besnikëri ndaj tij dhe Islamit. Në këtë mënyrë, klasa ushtarako-administrative osmane, në viset shqiptare, duke qenë etnikisht e njëjtë me të qeverisurit e vet, ka zotëruar jo vetëm pushtetin politik, por edhe atë ekonomik, duke u bërë faktor i rëndësishëm për depërtimin e Islamit në radhën e bashkëkombësve të vet.²⁵

Përmasat e gjera të përhapjes së Islamit në tokat shqiptare kanë lidhje edhe me ballafaqimet e ashpra të armatosura të popullit shqiptar me ushtritë osmane për dhjetra vite për mbrojtjen e lirisë dhe pavarësisë së tokave shqiptare. Qëndresa gjatë shek. XV kulmon me epokën e Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe përfundon me rënien e Shkodrës.

21. Shih Gjon Berisha, fq. 83.

22. Kryepiskopi Anastas Revista Kërkim 13, Tiranë 2015 fq. 7.

23. Shih Gjon Berisha, fq. 85.

24. Shih Historia e Popullit Shqiptar, fq. 596-597; Edwin Jacques. (1995) Shqiptarët, Tiranë, fq. 240-256.

25. Po aty, fq. 606.

Shkak tjetër ishte pamundësia e shtresës së varfër për të paguar taksat e ‘xhizjes’. Mospasja e një feje unike, por e dy besimeve të krishtera, e shoqëruar kjo me mospajtime dhe kundërshtime të vazhdueshme midis tyre, ishte një faktor specifik me rëndësi të madhe për dobësimin e qëndresës ndaj depërtimit të fesë islame.²⁶

c- Kryepiskopi Anastas thekson edhe një shkak madhor: një filologji e krishterë në gjuhën e tyre amtare. Mungesa e një organi gjuhësor të zhvilluar dobësoi rezistencën fetare të shqiptarëve, të cilët ishin të detyruar, që përveç gjuhës së tyre, e cila mbetej e pashkruar, të përdornin gjuhën e dytë, madje edhe të tretë: myslimanët arabishten dhe osmanishten, ortodoksët greqishten, kurse romano-katolikët latinishten dhe italishten. Nëse do të ishte formëzuar në kohën e duhur gjuha kombëtare shqiptare dhe do të ishin përkthyer në atë qoftë edhe një pjesë nga pasuria e teksteve të krishtera, siç ndodhi me popujt e tjerë ballkanikë, kjo gjë do të ndihmonte në zhvillimin e ndërjegjes së qëndrueshme të krishterë, evoluimi fetar ndoshta do të ishte i ndryshëm.²⁷

Më vonë, kur filluan lëvizjet çlirimtare brenda perandorisë otomane, shumë herë ortodoksët shqiptarë bënë aleancë me ortodoksët e tjerë të Ballkanit. Shembull kemi sidomos rastin kur ortodoksët shqiptarë morën pjesë në revolucionin grek. Numri i heronjve arvanitas të rënë për pavarësinë e Greqisë është shumë i madh. Bëmat dhe kontributi i tyre është mpleksur fort me atë vend, me historinë e tij.

Tek kjo ngjarje e madhe historike protagonistët kanë qenë shqiptarët nga krahinat jugore, lindore, perëndimore dhe deri veriore të Shqipërisë. Në listat dhe dokumentet historike të kohës, në betejën simbol të revolucionit grek, të Mesolongjit, kishte shumë shqiptarë nga të gjitha trojet shqiptare, madje edhe nga Shkodra, Kukësi, Dibra. Kishte edhe arvanitas myslimanë si Ali Farmaqi, që luftuan përkrah të krishterëve në luftën kundër osmanëve. Edhe një numër i madh nizamësh turq, të cilët ishin nga vise të ndryshme të Shqipërisë, në betejën e Mesolongjit dhe beteja të tjera, u bashkuan me forcat kryengritëse duke braktisur repartet e tyre. Në këtë përmbledhje nuk futëm as kontributin e jashtëzakonshëm të shqiptarëve suljotë dhe të kapedanëve të tyre, të cilët vërtet bënë një epokë të lavdishme në historinë e kësaj treve legjendare. Heroi i Mesologjit, Marko Boçari dhe Boçarët e tjerë, dera e Xhavellajve etj, janë heronj, që renditen në panteonin e lirisë për pavarësinë e Greqisë. Ata janë të shumtë dhe Bajroni thotë se ata janë shqiptarë, që vijnë nga derë heronjsh.²⁸

26. Po aty, fq. 597, 598, 606.

27. Shih Kryepiskopi Anastas, revista Kërkim, nr. 13, fq. 7-8.

28. Irakli Koçollari. (1994) Arvanitët, Tiranë, fq. 181-185; Petrika Thëngjilli (2005) Shqiptarët midis Lindjes dhe Perëndimit 1823-1875, Tiranë, V.4 fq. 159-179.

Rasti i dytë është kur Sulltani donte të përdorte potencialin ushtarak të Shqipërisë jugore për të shtypur kryengritjen greke. Porta e Lartë donte të grumbullonte 40 mijë ushtarë shqiptarë, kryesisht nga Shqipëria e jugut. Në mars 1822 u shpall në të gjithë Shqipërinë fermani për mobilizimin e një burri për çdo shtëpi, por Sulltani nuk ia arriti qëllimit, sepse popullsia ishte e mërzitur nga lufta dhe toskët, shumica myslimanë, donin të mbanin marrëdhënie miqësore me grekët e vllahët, me të cilët i afrohte bashkëjetesa paqësore shumëshekullore, bashkëpunimi si fqinjë dhe mjaft zakone të përbashkëta.

Edhe bejlerët shqiptarë, të dëshpëruar pas vrasjes së Ali Pashës, nuk i vunë veshin thirrjes për mobilizim. Osmanët u përpoqën të futin elementin fetar në mënyrë që shqiptarët myslimanë të luftonin kundër grekëve. Sulltani në vitin 1823 urdhëroi Vezir Mustafa pashë Bushatllin të nisej me forcat e gegëve kundër Greqisë, por repartet shqiptare u treguan pasive dhe dezertuan. Konsulli francez i Korfuzit De Shantal shkruan se “shqiptarët myslimanë nuk deshën të luftonin kundër grekëve”.²⁹ Qëndrimi i forcave shqiptare, që u endën rrugëve ose që nuk ndërmorën thujtje asnjë veprim serioz luftarak si gjatë “marshimit”, ashtu edhe gjatë “rrethimit” të Mesologjit, minoi ekspeditën e vitit 1823.

Kur Fuqitë e Mëdha, në protokollin e datës 4 prill 1827, kishin vendosur të përkrahnin çështjen greke, për shqiptarët u bë e qartë se nuk duhej të merrnin pjesë në luftën kundër Greqisë. Feudalët spahinj shqiptarë hynë në bisedime me qeverinë greke për të përcaktuar qëndrimin që do të mbanin të dy palët në konfliktin që kishte shpërthyer. Gjatë bisedimeve të nëntorit 1828, të dy palët u zotuan të mos sulmonin trojet e njëri-tjetrit.³⁰

Në vitin 1828/29 filloi lufta ruso-turke. Porta e Lartë i drejtoi sytë në Shqipëri që të dërgonte forcat e Shqipërisë veriore në frontin e Danubit kundër rusëve për të shpëtuar Vidinin nga pushtimi rus. Bushatlliu u nis me ngadalë dhe u rreshtua përkrah osmanëve në luftë kundër rusëve, dëboi rusët nga qyteti Orahova. Prania e 40 mijë ushtarëve shqiptarë përkrah osmanëve i dha guxim Sulltanit, por ai bëri paqe me rusët dhe Bushatlliu u kthye në Shkodër. Gjatë shekujve XVI-XVII forca kryesore kundër turqve ishte fshatarësia raja (të krishterët) dhe ajo e krahinave të vetqeverisura, kurse në shek. XVIII shtohen edhe klerikët e lartë të krishterë dhe feudalët aristokratë shqiptarë. Tiparet çlirimtare të kryengritjeve ishin mpleksur me ato shoqërore, kjo në varësi nga kushtet historike, forca dhe organizimi. Kjo pjesëmarrje e besimtarëve të të gjitha feve shpjegohet me tolerancën fetare.³¹

Islamizimi i popullsisë shqiptare ishte një proces me ndikime të ndjeshme

29. Shih Historia e Popullit Shqiptar..., fq. 673-678; shih Petrika Thëngjilli fq. 159-179.

30. Po aty, fq. 678- 681.

31. Po aty, fq. 586 dhe Petrika Thëngjilli. (2003) V.2 Tiranë, 2003, fq. 62-64.

dhe me shumë aspekte të kulturës shpirtërore. Në martesat dhe krijimtarinë artistike u dukën shpejt elementet e kulturës islame dhe orientale.

Me përhapjen e fesë islame në viset shqiptare u thellua më tej diversiteti fetar, gjë që potencialisht krijonte kushte për përçarjen dhe shpërbërjen e kombit shqiptar, mirëpo një gjë e tillë nuk ndodhi për arsye se realiteti i ri fetar ishte një mozaik i vendosur, i fuqishëm, përforcuar në rrjedhën e historisë nga veprimet e faktorëve të konvergencës, siç ishin tiparet etnopsikologjike, gjuha dhe kultura e përbashkët. Nga ana tjetër, ashtu sikundër Krishtërimi (ortodoks dhe katolik) edhe Islami te shqiptarët mbeti një fe popullore, larg intolerancës dhe fanatizmit doktrinor. Për më tepër, përhapja në viset shqiptare e tarikateve islame, sidomos e bektashizmit, e zbuti shumë klimën e marrëdhënieve ndërfitare tek shqiptarët. Bektashizmi, duke qenë afër në të dy besimet (krishtërimin e islamizmin), kontribuoi në frenimin e prirjeve ndarëse tek populli dhe në fuqizimin e lidhëzave të unitetit mbi baza etnike dhe kombëtare. Të dhënat e dokumentacionit historik përbëjnë vërtetimin më të sigurt për ekzistencën e tolerancës dhe të bashkëjetesës pa probleme të shqiptarëve të besimeve të ndryshme.³²

Nga ana tjetër, pjesëmarrja e përbashkët e popullsisë shqiptare si të krishterë, ashtu edhe myslimane në lëvizjen çlirimtare antiosmane flet qartë pas cektësinë e ndarjes fetare përballë vetëdijes së bazuar nënjësinë kombëtare. Thellimi i ndryshueshmërisë fetare gjatë sundimit osman, për shkak të kalimit të pjesës më të madhe të popullsisë së krishterë në fenë islame, nuk e çenoi karakterin etnik të popullit shqiptar, përkundër pohimit të ndonjë studiuesi se popullsia e islamizuar bashkë me fenë humbiste edhe ndërgjegjen kombëtare.³³

Me gjithë ndasitë fetare, racore dhe etnike gjatë periudhës së Perandorisë Osmane u krijua në hapësirën më të gjerë të Ballkanit një qytetërim i përbashkët në krijimin e të cilit kontribuonin të gjithë popujt, duke ofruar gjeninë e tyre krijuese dhe veçantitë e tyre. Në këto ngjizje morën pjesë edhe shqiptarët, pavarësisht fesë.

Periudha e tretë

Kjo periudhë shtrihet nga krijimi i shtetit të ri shqiptar deri në pushtimin e vendit nga Italia fashiste (1912-1939). Në këto faza bashkekzistenca e komuniteteve fetare mbështetet në një përpjekje të përbashkët të shqiptarëve për të theksuar identitetin e tyre kombëtar. Zhvillohet filologjia shqiptare dhe theksohet sidomos origjina etniko-racore, si përbërësi bazik i unitetit të Shqipërisë.

32. Shih Historia e Shqipërisë, fq. 607.

33. Po aty, fq. 608.

Ndarja e popullsisë në tre besime shtroi para lëvizjes kombëtare shqiptare disa detyra të veçanta, që nuk i ka njohur ajo e vendeve të krishtera ballkanike. Feja e përbashkët e krishterë, ndërgjegjja fetare krahas ideve kombëtare ishte një faktor, që i ofronte shpirtërisht elementet përbërës të këtyre popujve dhe që shpejtoi bashkimin e tyre kombëtar në luftën çlirimtare kundër pushtuesve otomanë, të cilët ishin myslimanë. Ndërsa në Shqipëri në shek. XIX, ku popullsia ishte e ndarë në tre besime të ndryshme, nuk mund të bëhej fjalë për këtë antagonizëm, të shtruar në rrafsh fetar. Në këto kushte, bashkimi i shqiptarëve në luftën kundër osmanëve do të arrihej, duke mos prekur ndërgjegjen fetare, por vetëm duke u mbështetur në parimin e kombësisë. Rilindasit bënë një punë të madhe, të vështirë, për të kapërcyer ndasitë fetare dhe politikën përçarëse të osmanëve.

Parimi “Feja e shqiptarit është shqiptaria”, që përshkon një literaturë të tërë politike e artistike të periudhës së Rilindjes, ishte politik, synonte bashkimin e shqiptarëve, pavarësisht nga përkatësia e tyre fetare. Duke marrë si të mirëqenë faktin se uniteti i kombit nuk mund të mbështetej mbi traditën fetare të përbashkët, mbetej vetëm:

1- Origjina e përbashkët, që u lartësua deri në sferën e të shenjtës, duke eliminuar ose shmangur të gjitha konfliktet e natyrës fetare dhe duke fuqizuar bashkëjetesën fetare.

2- Ata evokuan dhe pasqyruan gjerësisht në letërsi epokën e Skënderbeut, luftën e tij çlirimtare kundër Perandorisë Osmane, më të fuqishmen e kohës. Me anë të Skënderbeut ata synonin të afirmonin vitalitetin e popullit shqiptar, aftësinë e tij për t’u bashkuar politikisht dhe të drejtën për të formuar shtetin e vet kombëtar.³⁴

Po japim disa shembuj konkretë sesi populli dhe kleri bëri përpjekje për ruajtjen dhe konsolidimin e bashkekzistencës paqësore. Shembujt gjenden tek libri (Beduli, 1997)³⁵, që flet për bashkësinë ortodokse të hershme të Tiranës:

“Me vendosjen e bashkësisë brenda në qytetin e Tiranës jo vetëm që nuk lindi asnjë lloj shqetësimi por lidhjet dhe marrëdhëniet e ndërsjellta, që ekzistonin më parë u forcuan më shumë. Hapja në treg e dyqaneve të rregullta prej zejtarëve ortodoks, organizmi esnafor i tyre, kontaktet ditore e personale të punës midis këtyre dhe vendasve shkëmbimi i vizitave në raste festash, gëzimesh vdekjesh e të tjera, të gjitha këto ndikonin përditë e më shumë në thyerjen dhe shkrirjen e akullit, që ishte formuar nga fanatizmi fetar i kohës dhe në krijimin e një atmosfere dashurie, respekti e mirëkuptimi të ndërsjellë midis bashkësisë orthodhokse dhe masave të gjera të popullsisë së qytetit. Natyrisht fanatizmi fetar bënte ç’bënte e ngrinte krye,

34. Po aty, (2007) V.2 Tiranë, fq. 28-29.

35. Dhimitër Beduli. (1997) Kodiku i kishës së Shën Prokopit të Tiranës, viti 1818-1921, fq. 56-60.

siç pamë, herë i nxitur nga pushtuesit osmanë për të mobilizuar masat që të luftonin për interesat e tij, herë nga propogandat e huaja, që t'u shërbente interesave të tyre.”

1- Rasti i parë ka ndodhur në vitin 1897, kur ishin acaruar shumë marrëdhëniet greko-turke për çështjen e Kretës. Popullsia e Kretës ishte ngritur në luftë për t'u bashkuar me Greqinë. Në kufijtë e Thesalisë dhe Janinës, Greqia kishte grumbulluar ushtri të gatshëm për t'u sulur në Shqipëri në një rast fitoreje të grekëve. Këtë rast Sulltani e shfrytëzoi menjëherë për të tërhequr myslimanët shqiptarë kundër Greqisë. Ai u përpoq që luftën në frontin e Janinës dhe Thesalisë ta paraqiste si luftë për mbrojtjen e islamizmit dhe territoreve shqiptare. Sulltani u premtoi shpërblime krerëve feudalë dhe bajraktarëve se në rast fitoreje, përveç privilegjeve të vjetra do t'u falte çifligje në Thesali. Me këto premtime Stambolli i arriti pjesërisht qëllimit.

Në Tiranë, pjesa më e madhe e feudalëve, nën presionin e osmanëve u hodhën në anën e Sulltanit dhe të nxitur nga fanatizmi fetar mendonin se në këto kushte duhet eliminuar bashkësia e vogël ortodokse e Tiranës, që të mos krijonte më pas ndonjë rrezik në rast fitoreje të Greqisë. Mendimi ishte marrë vesh nga njerëzit e bashkësisë ortodokse dhe kishte shkaktuar alarm të madh. Për fat të mirë, u gjendën burra të urtë, i ati i Fuat Beut, Ali Bej Toptani etj., të cilët duke marrë parasysh qëndrimin korrekt të bashkësisë ortodokse të Tiranës dhe duke u nisur nga fakti se bashkësia ishte nën mbrojtjen e shtëpisë së Bargjinëve e më vonë të Toptanëve, ngulën këmbë edhe në emër të besës tradicionale shqiptare, u hoq dorë nga ai plan i shëmtuar, që do të ishte një njollë e zezë në historinë e qytetit të Tiranës.

2- Rasti i dytë ishte nga fundi i dhjetorit 1901. Në 25 dhjetor festohej Krishtlindja. Pas festës një ortodoks i ri, Kol Roçi, hipi në këmbanore dhe i ra këmbanës. Muezini i xhamisë së Karapicit, Sali Efendiu shtiu me pushkë nga minarja e xhamisë për të vrarë Kolën. Koli shpëtoi. U trondit e tërë bashkësia ortodokse, burrat mbyllën kishën. Këshilli i kishës me në krye Mitropolitin hodhën poshtë kërkesën e të rinjve ortodoksë për të vrarë muezinin, kur të këndonte nga minarja akshamin... Autoritetet lokale e kapën shkaktarin, e burgosën dhe premtuan se do të bënë detyrën e tyre. Mitropoliti dhe këshilli i kishës ishin të mendimit se ky veprim nuk dukej të ishte provokacion i myslimanëve të qytetit, pasi ortodoksët nuk kishin dhënë shkak që të pritej një akt të tillë.

3- Rasti tjetër më është thënë mua personalisht nga një trashëgimtar i një familjeje të vjetër ortodokse Lasku të Tiranës. Kur ushtria serbe sulmoi Tiranën, gjatë Luftës së Parë Botërore, ortodoksët dolën përpara ushtrisë serbe me kryqe, ikona e lutje duke u kërkuar që të mos e digjte qytetin dhe të vriste myslimanë, sepse ata kishin

bashkëjetuar paqësisht njeri me tjetrin në qytet dhe kështu u shmang një masakër, që do të cënonte bashkëjetesën fetare. Gjatë kësaj periudhe kohore formohet KOASH.³⁶ (Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë), për të përfshirë brenda vetes të gjithë shtetasit ortodoksë brenda territorit të shtetit shqiptar, pavarësisht nga gjuha ose prejardhja (shqiptarë, grekë, vllahë, sllavë). Brenda klimës së përgjithshme të trazirave dhe nacionalizmit në Ballkan u bënë përpjekje të shumta për të krijuar armiqësi dhe kundërvënie midis komuniteteve ortodokse të origjinave të ndryshme racore, por si përfundim fryma e ekumenicitetit të ortodoksisë mbizotëroi.

Patriarkana Ekumenike duke njohur Autoqefalinë e kësaj kishe lokale më 12 prill 1937 theksoi:

“Të gjithë komunitetet në Shqipëri pavarësisht nga kombësia do të shijojnë në të ardhmen të njëjtat kushte të zhvillimit fetar dhe të drejtave të tyre për të cilat kisha u përkujdes t’i sanksionojë në mënyrë zyrtare.”³⁷

Në këtë periudhë dallohen qartë komunitetet fetare bazë të Shqipërisë. Sipas statistikës zyrtare të vitit 1927 myslimanët sunitë dhe bektashinj përbëjnë 67.5 % të popullsisë, ortodoksët 22.3 % dhe romano-katolikët 10 %³⁸.

Marrëdhëniet e besimtarëve të komuniteteve të ndryshme zhvillohen normalisht, por pa munguar poshtë sipërfaqes të ekzistojnë konflikte në kohë të ndryshme. Sidomos çështja e uniatizmit, pra ortodoksët të kalonin nën pushtetin e kishës Katolike. Materialet arkivore shqiptare kanë raporte të shumta për veprimtarinë unite në vitet 1920-1930 dhe vitet e pushtimit italian 1939-1943. Nga dokumentacioni vërehet se në vitet 30-të regjimi i Zogut ka luajtur një politikë të mesme kundrejt uniatizmit, duke mos u shquar as për goditje të forta, si dhe duke mos e përkrahur atë. Pozicioni i shtetit kushtëzohet nga rrugëtimi i ngjarjeve të pritshme. Ndikimi i uniatizmit ishte më i madh në Elbasan, Korçë, Vlorë, ndërsa kisha e vetme e ndërtuar ishte në Elbasan.³⁹

Periudha e katërt

Sipas radhës, periudha kohore 1939-1944 përfshin së pari aneksimin italian dhe në vazhdim pushtimin gjerman. Në këtë fazë të pushtimit, komunitetet fetare vazhdojnë të bashkekzistojnë, por është shfaqur haptazi preferenca e pushtetit për

36. Kryepiskopi Anastas. (2013) Ringritja e Kishës Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë 1991-2012, Tiranë, fq. 11.

37. Kryepiskopi Anastas, revista Kërkim, Nr. 13, Tiranë, 2015: fq. 9.

38. Teki Selenica, Shqiptarët 1927, Gazeta Shqiptare 24/4/93 fq. 14.

39. AQSH, fondi 152/13 viti 1930 dosje 179, fondi 559 viti 1936-1938 dosja 7.

kishën Romano – Katolike. Ushtrohet presion direkt dhe indirekt mbi KOASH-in për ta detyruar atë të afrohet me Kishën Katolike, duke e përfshirë brenda Unia-tizmit, siç ndodhi me arbëreshët në Itali. Në vitin 1940 u formua për Shqipërinë e Jugut një administratë apostolike, e cila iu besua delegatit apostolik De Nigris. Ky, në takimet me Jakomonin, përsëriste se vetëm një asimilim progresiv i masës së besimtarëve ortodoksë nga katolicizmi mund të favorizonte bashkimin e ardhshëm të KOASH-it me Romën.

De Nigris shtonte misionet midis të krishterëve ortodoksë dhe mbronte me çdo mënyrë këtë tip prozelitizmi. Italianët dëbuan dy peshkopët e dioqezave të Korçës dhe Gjirokastrës: Evlogj Kurilën dhe Pandeileimon Kotoko.⁴⁰ Qëllimi ishte zëvendësimi me peshkopë unitë nga Kalabria. Jakomoni, mëkëmbësi i mbretit italian në Shqipëri, i bëri presion kryepiskopit Kristofor Kisi, që në vendet vakante të dy dioqezave ortodokse të emëroheshin peshkopë unitë nga Kalabria. Hirotonia e Irine Banushit, si peshkop në dioqezën e Gjirokastrës 1/2/1942 dhe kapitullimi i Italisë në shtator 1943 bënë që të dështonte aneksimi i KOASH-it nga Vatikani.⁴¹

Periudha e pestë

Ajo shtrihet nga ardhja e komunizmit në pushtet në Shqipëri deri në rënien e tij (1944-1990). Në 23 vitet e para bashkëjetesa e komuniteteve zhvillohet nën zgjedhjen e përbashkët të sistemit ateisto-komunist, që persekuton pa mëshirë besimet fetare, duke pretenduar se kështu sigurohet bashkimi etnik dhe përparimi i vendit. Persekutimi nuk bën dallim në marrjen e pronave, propagandën kundër fesë, shkatërrimin e tempujve, persekutim dhe burgosje klerikësh dhe laikësh⁴².

Shpesh myslimanë, ortodoksë dhe katolikë u ndodhën së bashku në kampe përqendrimi e burgje dhe bënë lutje të përbashkëta. Po jap një shembull. Vitet e para, pas Luftës së II Botërore në burgun e Tiranës, ku ishte futur ajka e inteligjencies shqiptare nga pushteti ateist, një nga persekutorët për t'u argëtuar nxjerr para të burgosurve dy figura të hierarkisë fetare, që ndodheshin të burgosur aty: Episkop Irineun dhe Haxhi Hafiz Ibrahim Dalliu, të dy të veshur me rrobat e tyre fetare. Me mburrje prej injoranti

40. AQSH, fondi 155 viti 1940 dosje 463 fq. 9.

41. Kristofor Beduli. (2000) Episkop Irine Banushi Martiri i KOASH-it-Tiranë, fq. 22-23-30; AQSH, viti 1942 fondi 155 dosja VIII-518 fq 3; AQSH, fondi 155 viti 1940 dosja VIII-436 fq 9; Roberto Moroko Dela Roka, Kombësia dhe feja në Shqipëri viti 1920-1944- Tiranë 1994 fq. 213-220.

42. Artan Hoxha Kisha Orthodhokse nën komunizëm 1945-1967 Tiranë dhjetor 2017 fq 67-95; Kristofor Beduli. (2000) Episkop Irine Banushi, Tiranë, fq. 17-19; Nos Xhuvani (2003). V. Xhuvani, Apostull i Atdhetarizmit dhe Orthodhoksisë Shqiptare, Tiranë, fq. 224-234; Piro Kondili KOASH-i në vitet e diktaturës komuniste, Gazeta Ngjallja, gusht, shtator, tetor, nëntor 2007 nr. 8, 9, 10, 11; Shih Historia e Popullit Shqiptar (2009) v.3, Tiranë, fq. 286-287; AQSH, fondi 536, viti 1946, dosja 97: fq. 1, 3, 12, dosje 1080: fq. 5-7; dosja 1088: fq. 53; dosja: 1176, fq. 1, etj.

pushtetari persekutor i heq kalimafin prej koke episkopit dhe e vendos mbi kokën e Hafizit dhe në të njëjtën kohë i merr taxhin Hafizit dhe e vë në kokën e Episkopit, i cili duke qeshur i thotë:

- Ndihem krenar që po mbaj këtë veshje të Zotit, - i përgjigjet ai.
- Po ti, o hoxhë, me këtë kapele prifti?
- Nuk e di a i takon ky nder kokës sime për të mbajtur këtë kalimaf të shenjtë, - përgjigjet ai.⁴³

Në 4 prill 1967 u dha sinjali për persekutimin absolut të fesë. Me dekretin e botuar në 22 nëntor 1967 komunitetet fetare u nxorën jashtë ligjit dhe Shqipëria u shpall zyrtarisht shteti i parë dhe i vetëm ateist në botë dhe në histori, ku me kushtetutë ndalohej çdo lloj shprehje fetare⁴⁴. Në piedestalin e së vërtetës hyjnore e të së hirshmes së fesë lartësohet ideologjia marksiste me identitet shqiptar: “Feja e shqiptarit është shqiptaria”- përsëriste Enver Hoxha, duke i dhënë kësaj fraze një ngarkesë të re kuptimore. Bashkekzistenca e komuniteteve fetare në Shqipëri mbërriti në një pikë tragjike, në heshtjen e skajshme të varrit⁴⁵.

Në të shkuarën mungesa e luftrave civile në Shqipëri u mbështet sipas periudhave në këto baza:

1- Në ekzistencën e një feje të vetme në kohën para skizmës së krishtërimiti (1054). Në fund të kësaj periudhe u vu re diferencimi i parë i një karakteri kryesisht gjeografik; ortodoksët në jug dhe romano-katolikët në veri.

2- Perandoria Osmane, bashkekzistenca sigurohej nga pushteti mysliman.

3- Faza e pavarësisë, bashkekzistenca mbështetet tek theksimi i origjinës dhe identitetit shqiptar.

4- Pushtimi fashist, bashkekzistencën e ruan balanca tradicionale e besimeve fetare.

5- Gjatë persekutimit komunist bashkekzistenca fetare vulozet nga futja në varr e komuniteteve fetare.⁴⁶









ORGANIZING INSTITUTIONS

University College "Bedër"
Catholic University "Our Lady of Good Counsel"
University College "Logos"
Austrian Embassy in Tirana

icid.beder.edu.al

Sponsor:

